



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 26 SHKURT 2016**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 26. FEBRUARA 2016. GODINE**

**SHKURT - FEBRUAR
2016**

Rendi i ditës

1. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës

Dnevni red

1. Izbor Predsednika Republike Kosovo

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
I nderuar ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zoti Greg Delavi,
I nderuar përfaqësues i Bashkimit Evropian, zoti Samuel Zhbogar,
Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të zyrave diplomatike në Republikën e Kosovës,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Të nderuar të pranishëm në këtë seancë,
I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, me kërkesë të grupit prej 43 deputetëve.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 104 deputetë. Andaj, fillojmë me punimet e seancës plenare me këtë rend dite:

1. Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për president të Republikës së Kosovës janë nominuar dy kandidatë: zoti Hashim Thaçi dhe zoti Rafet Rama.

I ftoj përfaqësuesit e propozuesve që para deputetëve të Kuvendit t'i paraqesin arsyetimet për kandidatët e nominuar për president. Për kandidatin zoti Hashim Thaçi, e ka fjalën Adem Grabovci, shef i Grupit Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeverisës,
Përfaqësues diplomatikë, ambasadorë të nderuar, përfaqësues i Bashkimit Evropian,
Të nderuar kolegë deputetë,
Sot është ditë e veçantë për të gjithë ne, për të gjithë qytetarët e Kosovës, meqë do të votojmë për zgjedhjen e Presidentit të vendit për mandatin e ardhshëm pesëvjeçar.

Ne deputetët e poshtëshënuar, në bazë të nenit 86, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 27, paragrafi 3, të Rregullores së Kuvendit, për postin e presidentit të Republikës së Kosovës e nominojmë zotin Hashim Thaçi.

Lista me nënshkrimet e deputetëve u është shpërndarë të gjithë deputetëve. Po ashtu, edhe biografia e kandidatit të nominuar nga ne u është shpërndarë të gjithë deputetëve.

Kemi të bëjmë me një kandidat, i cili është i njohur për të gjithë për meritat, dëshmimin dhe të gjitha. Prandaj, për mua dhe për ne të gjithë është nder dhe kënaqësi e veçantë që ta kem një kandidat të kalibrit të Hashim Thaçit që të drejtojë apo t'i marrë përgjegjësitë e institucionit të Presidencës për mandatin pesëvjeçar.

Ju bëj thirrje të gjithëve ta jepni votën tuaj. Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar zoti Grabovci!

Tani për kandidatin zotin Rafet Rama, kush do ta marrë fjalën? Zonja Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Ambasadorë të nderuar,

Të nderuar media,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ndihem jashtëzakonisht e nderuar dhe e privilegjuar që sot para jush dhe para qytetarëve të Republikës së Kosovës ta prezantoj kandidatin për president të Republikës së Kosovës, zotin Rafet Rama, një kandidat i denjë, një kandidat me virtyte të larta njerëzore dhe kombëtare, një kandidat i cili është dëshmuar nëpër etapat e ndryshme historike për vendin.

Prandaj, konsideroj që Rafet Rama është një kandidat i denjë që sot të zgjidhet president i Republikës së Kosovës, dhe ju ftoj që ta votoni.

(Duartrokitje)

KRYETARI: Faleminderit, zonja Musliu!

Për verifikimin e kushteve të kandidatëve të nominuar për president, propozoj që Kuvendi ta autorizojë Komisionin për Legjislacion, Mandate dhe Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për autorizimin e këtij komisioni. Kush është për? Kush është kundër? A ka abstenim? Konstatohet se Kuvendi e autorizoi Komisionin për Verifikimin e plotësimit të kushteve të kandidatëve për president.

Kërkoj nga ky komision që menjëherë të mblidhet në sallën 302 dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin. Komisioni, në sallën 302. Pauzë, 15 minuta!

E lus komisionin të tërhiqet në sallë, 15 minuta. Seanca vazhdon pas pauzës. Faleminderit për mirëkuptim!

* * *

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Jemi në vazhdimin e seancës.

Kryetarja nuk qenka këtu, prandaj e ftoj zëvendëskryetaren e Komisionit, zonjën Selville Halimi, që ta paraqesë raportin. Albulenë, je kryetare e komisionit, e ke fjalën ti për raportin? Unë shkoj vetëm në bazë të kësaj çfarë kam këtu, institucionale. Atëherë zonja Selville Halimi e paraqet raportin.

SELVILLE HALIMI: I nderuar kryetar,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,
Dhe ju të pranishëm,
Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit jep raport për verifikimin e kushteve të kandidatëve të nominuar për president të Republikës së Kosovës.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në pajtim me vendimin e seancës plenare, datë 26 shkurt 2016, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2016, e shqyrtoi dokumentacionin e kandidatëve të nominuar për president të Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi dhe zoti Rafet Rama.

Lidhur me plotësimin e kushteve të parapara me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për presidentin e Republikës së Kosovës, për t'u zgjedhur president i Republikës së Kosovës, Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar, konstatoi: Kandidatët e nominuar për president të Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi dhe zoti Rafet Rama, i plotësojnë kushtet e parapara me dispozitat e Kushtetutës dhe të Ligjit për presidentin e Republikës së Kosovës për t'u zgjedhur president i Republikës së Kosovës.

Andaj, mund të procedohet me votimin e kandidatëve të nominuar për president të Republikës së Kosovës.

Prishtinë, 26 shkurt 2016.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Halimi!
Për diskutime, radhën e kanë kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, nuk do. Ok-ej!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës? Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje"? Në emër të Grupit Parlamentar, zoti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,
Ju që po qëndroni në shesh, në protestë sot, dje e pardje kundër kësaj Qeverie, kundër këtyre shkelësve të Kushtetutës dhe kundër këtyre zaptuesve të shtetit që sot janë bërë gati ta zaptojnë majën e tij, Presidencën.

Unë sot e mora fjalën në emër të grupit parlamentar sepse Glauk Konjufca, kryetar i Grupit Parlamentar, nuk është këtu në sallë. Ai nuk është në sallë, sepse është në burg. Ai është duke u mbajtur në burg që prej 16 shkurtit për ta përcjellë një seancë, për t'u dërguar në një seancë gjyqësore, e cila ka të bëjë me një rast, me një aktivitet, me një aksion politik të Lëvizjes “Vetëvendosje” që ka ndodhur në vitin 2009 kundër Misionit të EULEX-it, pasi misioni i EULEX-it kishte nënshkruar marrëveshje protokolli me Policinë e Serbisë për këmbim të informatave. Dhe, kështu, EULEX-si filloi gradualisht ta bëjë pjesë Policinë e Serbisë në sistemin e brendshëm të sigurisë së Kosovës. Pra, në atë që ju keni dëshirë ta quani sundim të ligjit, në atë që në fakt që bëhet pra nëpërmjet sunduesve të ligjit.

Dhe, ky protokoll policor natyrisht që pastaj ka sjellë informata këtu dhe ka dërguar informata prej këtu atje. Rrjedhimisht, sot e kemi EULEX-in që kur erdhi na premtonte që do të merret me rastet e korrupsionit, e tash merret vetëm me rastet e krimeve të luftës. Shoku i juaj, pra Sami Lushtaku, sot është në burg për krime lufte, ku e ka mbajtur EULEX-si. Besoj që disa informata i ka marrë edhe prej Policisë së Serbisë për shkak të këtij protokolli, ose edhe për shkak të këtij protokolli kundër të cilit ne atëherë kundërshtuam dhe për të cilin tash po përndiqemi nga pushteti që ju po e quani pushtet demokratik.

Por, t'i kthehemi temës, edhe pse kjo nuk është jashtë temës.

Dialogu Thaçi-Daçiq ka filluar më 19 tetor të vitit 2012. Pra, atëherë nisi ky që e mori epitetin e dialogut politik dhe marrëveshja e parë e nënshkruar ndërmjet këtyre dy personave është Marrëveshja e 19 prillit 2013. Saktësisht 6 muaj pasi ka filluar dialogu pas takimit të parë në Bruksel, Hashim Thaçi na e solli marrëveshjen e cila është fondamenti, pra bazamenti i “Zajednicës”. Kjo i bie praktikisht që Thaçi e ka filluar “Zajednicën”, ndërkohë që i ka rënë pastaj Isa Mustafës ta kurorëzojë atë në gusht 2015, dhe ky e bëri atë pa hezitim, pra e ndoqi Thaçinin hap pas hapi.

Mirëpo këtu duhet të evidentohet që “Zajednicën” e kemi dhuratë nga Hashim Thaçi, i cili sot në biografinë e tij na ka treguar se po do të bëhet president, sepse i paska shërbyer shumë këtij vendi, lirisë së tij, pavarësisë së tij edhe mirëqenies.

Por, jo vetëm kaq. Hashim Thaçi e nisi dhe e përfundoi edhe demarkacionin. Pra, sot janë bërë 6 muaj që kur është nënshkruar marrëveshja në Vjenë për demarkacionin, në të cilin nënshkrimi i parë vjen i ministrit të Punëve të Jashtme, pra Hashim Thaçi, e i dyti pastaj ky që e ndoqi Hashim Thaçinin më pas, Skender Hyseni.

Dhe, këta dy persona, por veçanërisht ky kandidati për president, në njërën anë e ka nënshkruar një marrëveshje, të cilën aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese e ka shpallur tërësisht antikushtetuese dhe mos harroni, jo vetëm Marrëveshjen e 25 gushtit 2015, por edhe elementet bazë, parimet bazë të Marrëveshjes 2013 janë shpallur antikushtetuese, ose siç ka dëshirë kjo klika e pushtetit ta quajë “jo në përputhje të plotë me Kushtetutën”, por edhe i ka falur toka Malit të Zi, së paku 8 000 hektarë, siç po thonë ekspertët vendorë, që janë falur me këtë marrëveshje demarkacioni. E njëri prej ekspertëve vendorë është një deputet i Lidhjes Demokratike të Kosovës, i cili shumë mirë që nuk qenka sot në sallë. Pra, ai ka vepruar sipas studimit të tij dhe sipas bindjeve të tij politike, ka thënë që nuk mund ta votoj unë, as t'ia mundësoj që të bëhet

president një njeri i cili ia ka falur 8 000 hektarë Malit të Zi me vetëdëshirë, me vetëdije edhe me bindje të plotë.

E keni parë që edhe dje, e edhe sot, është bërë një debat jashtëzakonisht i madh nëpër mediet e Kosovës, i cili kryesisht përqendrohej në atë nëse Lista serbe do të jetë prezent në sallë sot për t'ia mundësuar kuorumin, ose edhe për të votuar për Hashim Thaçin, për ose kundër.

Dhe, ky debat në fund rezultojë me ardhjen e Listës serbe këtu, që i bie praktikisht pas takimeve të panumërta që i kanë pasur ata në Beograd, e pas takimeve që i kanë pasur, herë thuhej në Gorazhdec, e herë në pjesën veriore të Mitrovicës, pastaj jo në Prishtinë, qenkan bindur që të vijnë dhe t'ia mundësojnë Hashim Thaçit zgjedhjen president. Kjo i bie praktikisht dy gjëra, njëra është që ka një marrëveshje të re me Listën serbe, ku disa prej kriterëve të kërkuara aty mbase edhe janë zotuar që t'i plotësojnë këta dy personat prapa meje, por kjo në fakt e shpërfaq një gjë tjetër, që për mendimin tim është edhe më skandaloze.

Ky debat e ka shpërfaqur pozicionin dhe mbështetjen politike që Hashim Thaçi e ka nga Vuçiqi për t'u bërë president. Praktikisht, ky debat na ka treguar që Hashim Thaçi nuk mund të bëhet president i Republikës së Kosovës pa ia dhënë bekimin edhe Aleksadar Vuçiqi i Serbisë, që i bie praktikisht që Hashim Thaçin president të Republikës së Kosovës po na e bën Vuçiqi, ai po ia mundëson për t'u bërë president i Republikës së Kosovës. E tash, ju po më thoni këtu që ne po zgjedhim president të Republikës. Cilin president të Republikës? Ai që e themelon "Zajednicën2, ai që i fal tokë Malit të Zi dhe ai që bekohet nga Vuçiqi, e nuk e di nëse Vuçiqi ka ndonjë në familjen e vet me prapavijë të priftërinjve, por si do qoftë politikisht po e bekon Hashim Thaçin për president. Dhe, ky po thoni që është president i Republikës! Cilës Republikë? Të Kosovës? Jo! Presidenti i Republikës së Kosovës nuk ka të drejtë ta cenojë rendin kushtetues të vendit, nuk ka të drejtë ta shkelë Kushtetutën e vendit dhe nuk ka të drejtë t'i falë tokë Malit të Zi, e aq më pak ka të drejtë që të bekohet nga një kryeministër i një vendi armik për t'u bërë president i vendit.

Pra, ky president mbase edhe do të bëhet, larg qoftë, siç thonë. Mirëpo, president i Republikës së Kosovës nuk do të jetë kurrë, sepse po bëhet president nëpërmjet shkeljeve, nëpërmjet shantazheve, nëpërmjet blerjeve dhe nëpërmjet bekimit që po ia japin, në këtë rast armiqtë më të përbituar të Kosovës, e që është Aleksandër Vuçiqi, kryeministër i Serbisë.

Pra, ju deputetë sot që do të votoni për, kundër, abstenim, e ku ta di unë si e keni mendjen, ta keni parasysh që po e bekon këtë bekim që vjen nga Serbia, po e bekon dhe po e mundësoni kapjen e shtetit, kapjen e Presidencës nga një preson i cili në karrierën e tij politike, e veçanërisht në karrierën e tij ekzekutive, i ka sjellë aq shumë dëme vendit sa nuk na del koha e plotë e kësaj seance, por edhe po ta vazhdojmë nesër e pasnesër, deri të hënën, që t'i numërojmë të gjitha. Por, megjithatë, mendoj që ia vlen t'i numërojmë disa.

Ky person, tash së fundi, të gjithë jemi dëshmitarë që e ka katandisur Kosovën si mos më keq me ndërsimin e tij për ta privatizuar dhe personalizuar anëtarësimin e Kosovës në UNESCO, dhe aty dështoi keq. Pra, plani i tij ka qenë që ta bëjë këtë anëtarësim me shpresën që do të ketë sukses anëtarësimi në UNESCO, që pastaj të dalë këtu e të na shkruajë biografi edhe një gjë - që unë e anëtarësova Kosovën në UNESCO. Mirëpo, pasi dështoi, tash nuk po thotë dështova në

UNESCO, por po thotë 'Kosova për pak sa s'u bë anëtare e UNESCO-s'. Pra, ja çfarë personi është ky - asnjë fije përgjegjësie publike dhe politike nuk mund ta marrë kurrë.

Në shtator të vitit të kaluar, e keni parë besoj të gjithë, e nëse s'e keni parë mund t'ua shfaqim kur të vini në shesh në protestë, që ky ka deklaruar në emisionin e Klan Kosova që nëse vetëm një germë ose një presje e Marrëveshjes së 25 gushtit është në shpërputhje me Kushtetutën, 'ne duhet të largohemi, duhet të japim përgjegjësi politike'. Jo një germë, krejt marrëveshja është në shpërputhje me Kushtetutën. Edhe letra në të cilën është shkruar dhe nënshkruar është në shpërputhje me Kushtetutën. Por, ky po insiston, le që nuk po largohet, por po do të hipë në Presidencë. Po do të bëhet sulltan i vendit, se ky atë mendje e ka - ta kontrollojë këtë vend në të gjitha sferat siç ka pretenduar vazhdimisht dhe siç 4 ka kapur sa ka qenë kryeministër, zëvendëskryeministër, e poste të tjera që i ka pasur.

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë sot e kam marrë fjalën këtu pak të flas me ju nëpërmjet kamerave televizive, sepse këtyre deputetëve këtu nuk kam edhe çka t'u flas, sepse këto që i thashë unë i dinë. Këta dinë edhe më shumë se unë, tjetër është së nuk guxojnë të flasin e nuk duan, por unë po flas me ju. Unë po ju them që nëse ky vendim për presidentin sot është i suksesshëm, nëse e kemi Hashim Thaçin president të vendit, ta keni parasysh që ky vend nuk do të mund më kurrë t'i hapë sytë. Ta keni parasysh që Republika e Kosovës nuk do të mund të jetë për sa kohë që në krye të saj vendoset një person i tillë, i cili e ka edhe të kaluarën, për të pasluftës po flas, por edhe të tashmen jashtëzakonisht të dëmshme dhe problematike për Republikën e Kosovës.

Prandaj, qytetarë të Republikës, ju që jeni të pakënaqur me këtë votim që do të bëhet sot, ju që jeni të pakënaqur me politikat e kësaj Qeverie, ju që jeni të pakënaqur me këtë degradim ekonomik e social që këta ia kanë bërë vendit, ju që jeni të pakënaqur me këtë kapje të shtetit që e kanë zgjeruar nëpër të gjitha bordet, ju që jeni të pakënaqur me këtë varfërim në të cilin ju ka sjellë ky pushtet, ju që jeni të pakënaqur me këta dy persona këtu, me qenien e tyre politike, dilni sot në shesh. Bashkohuni në shesh në protestë dhe do të qëndrojmë aty derisa të largohen këta.

Edhe një herë po e përsëris, pavarësisht votës këtu,...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, mos ua ndërprit fjalën!

VISAR YMERI: Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zonja Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Desha ta pyes Isën, se tash më s'mund t'i drejtohem si kryeministër, pasi e ka shkelur Kushtetutën dhe moti nuk është kryeministër legjitim i këtij vendi: Në kohën e Rrahman Morinës, a ka pasur kaq shumë milicë, qysh ka sot policë, se nuk më kujtohet, kam qenë e re, veç e di që prindërit e mi e kanë përjetua të njëjtën. Kështu kanë qenë edhe atëherë - milicë në sallë, dhe Hashimit t'i them a po të vjen marre.

Derisa kemi mbërri këtu, kemi dërguar letra, kemi thirrur seanca, kemi bërë peticione, i kemi ndërmarrë të gjitha veprimet parlamentare për ta ndalë një të keqe së sot ka dalë në rrugë. Çka keni bërë ju, pushteti? Me kokëfortësi e keni injoruar çdo përpjekje demokratike që nëpërmjet debatit, seancave, interpelancave, pyetjeve parlamentare, të cilave nuk u jeni përgjigjur kurrë, ta gjejmë një zgjidhje dhe të mos mbërrijë gjendja këtu ku ka mbërri sot. Përkundrazi, ju ka mjaftuar që me kokëfortësi ta injoroni opozitën, t'i injorua 200 mijë qytetarë, peticionin e tyre, t'i injoroni protestat e 28 nëntorit, të 17 shkurtit, protestën e 9 janarit dhe të gjitha reagimet që kanë ardhur nga qytetarët për t'i ndaluar dy marrëveshjet e dëmshme. Ju jeni mjaftua me kokëfortësi për ta vazhduar korrupsionin, krimin e organizuar që e ka kapluar vendin. Jeni mjaftua që për çdo ditë ta zaptoni edhe një bord që duhet të jetë i pavarur. Jeni mjaftuar të vazhdoni të abuzoni me Buxhetin e Republikës së Kosovës, ndërkohë që opozita nuk ka qenë këtu.

Pra, keni vazhduar ta korruptoni shtetin, ta thelloni mbikëqyrjen e gjykatave, të arrestoni deputetë, t'i mbani në burg, t'i lëshoni kur u është tekur, t'i merrni prapë, jashtë çdo procedure, jashtë çdo rregulli.

Mjafton që me pasion shumë të madh keni vazhduar ta mbron kthimin e Serbisë në Kosovë, 16 vjet pas lufte. Edhe po shihet që goxha shumë përkrahje keni pasur edhe prej deputetëve.

Unë nuk po befasohem prej juve që jeni prapa, por po befasohem prej kolegëve që s'iu dëgjua zëri. Megjithatë, do të dalin nesër për të kërkuar votë dhe besoj që ajo votë do të jetë votë për "Zajednicën" dhe votën për faljen e tokave.

Kur ne kemi ofruar harta, i kemi dorëzuar edhe në ambasadat e nderuara, nuk kemi marrë përgjigje, sepse ju keni vazhduar të thoni 'ne nuk e kemi humbur asnjë milimetër tokë', e ashtu nuk qëndron.

Të gjitha studimet të cilat i kemi dëshmuar nëpërmjet materialeve të dëshmuara e thonë të kundërtën. Ju i keni falur 10 000 hektarë tokë, keni falur burime të ujit, e keni lënë Kosovën të shterohet, sepse kështu keni bërë edhe me zonat tjera.

Sot me "Zajednicën" po e falni edhe Ujmanin, po e falni edhe Brezovicën, po e falni edhe "Trepçën".

Dje jeni takuar me Listën serbe. A del Hashimi, që sot po pretendon të zgjidhet president, të na tregojë çka i ka premtuar dhe çfarë garancish u ka dhënë, se dje të njëjtit kanë thënë që ne nuk e votojmë Hashim Thaçin president, e sot në mëngjes po thonë e votojmë, çka u ka premtuar dje, cilat janë garancitë shtesë? Çka do të shesësh më shumë për ta marrë një post për vete? Ke shitur goxha shumë nëpërmjet privatizimit e nëpërmjet proceseve, ku duart tua kanë qenë thellë në korrupsion, e çka do të shesësh tani të fundit herë?

Çka u ka bërë deputetëve të LDK-së? Me çka i ka shantazhuar, me çka i ka ble? Ku janë votuesit e Rugovës sot, të cilët i kanë votuar me premtimin që 'kurë me Hashimin'. Janë jashtë me opozitën. Nuk janë duke festuar, se kjo nuk është festë. Jashtë është populli duke kundërshtuar zgjedhjen e Hashim Thaçit president. Nuk është duke festuar.

Deputetët janë të obliguar ta zbatojnë vullnetin e popullit. Mos e bëni të kundërtën se nesër do të ju vij turp siç ju vjen sot disave të cilët në momente të caktuara historike kanë vepruar në kundërshtim me interesat e Kosovës. Edhe atëherë kanë qenë vetëm 10 deputetë, të cilët i kanë kundërshtuar ndryshimet kushtetuese për të cilat edhe atëherë shumica ka thënë nuk i bëjnë dëm Kosovës. Por, shumë vite më pas Kosova është dashur të çlirohet me luftë.

Po dua edhe një herë të rikapituloj se çfarë ka ndodhë ndërkohë që ne kemi qenë me popullin dhe me qytetarët.

Njeriu i cili sot po pretendon të zgjidhet president, qytetarët e Republikës së Kosovës më 17 shkurt i quajti me bisht. Njerëzit me bisht! Kështu na kanë quajtur edhe të tjerët historikisht, derisa u pa, u vërtetua dhe u fitua një përkrahje ndërkombëtare dhe u hoq ajo dilema se shqiptarët janë popull me bisht. E Hashimi e përsëriti prapë, më 17 shkurt tha 'ju jeni me bisht, keni ikur me bisht nën shalë'.

S'po e përmendi kullotjen e grave se po më vjen keq të bie në atë nivel dhe të flas me atë gjuhë të cilën po e dëgjojmë prej atyre që po vazhdojnë dhunshëm dhe jashtë çdo rregulli kushtetues të qëndrojnë në pushtet.

Ajo çka po ndihet jashtë, edhe një herë, është kundërshtim për njeriun i cili është kandidat për president.

Mirëpo, vuajtjet të cilat ky njeri ua ka shkaktuar qytetarëve të Republikës së Kosovës në 16 vjetët e fundit janë shumë më të mëdha se këto zhurma që po dëgjohen tani dhe këto vuajtje nuk ia fal askush.

Është pak më shumë se një vit që 150 mijë qytetarë të Republikës kanë ikur prej këtyre njerëzve. Ata po vazhdojnë të qëndrojnë nën ura nëpër Evropë, po vazhdojnë të qëndrojnë me njerëz që ikin nga luftërat, e Kosova nuk është në luftë, por Kosova është e zaptuar, e korruptuar. Në Kosovë nuk ka të ardhme për të rinjtë dhe të rejtat, sepse këta njerëz nuk lejojnë ardhjen e investitorëve, nuk lejojnë zhvillimin ekonomik të vendit. E kanë zaptuar çdo pore të shtetit për të vazhduar të qëndrojnë në pushtet dhe prapë po insistojnë në masa të dhunshme, me mijëra policë, nën zhurmën e qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët po të kundërshtojnë Hashim, nuk po festojnë që të zgjidhesh president.

Ti, po të kesh pak dinjitet, jo president i Republikës së Kosovës, por president i globit po të jetë, ishe ngrehur sot e kishe dalë në këtë foltore, kishe kërkuar falje për të gjitha këto trazira që po i shkakton me veprimet dhe qëndrimet tua dhe kishe dhënë dorëheqje. E kishe lejuar vendin të shkojë në zgjedhje, që të flasë populli, qytetarët t'i legjitimojnë institucionet e ardhshme demokratike. Mos e mbaj vendin peng. E ke zaptuar dhe e ke mbajtur peng 16 vjet, s'keni të drejtë ta mbani peng edhe sot. Nuk ke të drejtë ta zaptosh dhe ta mbash peng edhe sot. Nuk ke të drejtë ta zaptosh dhe ta mbash peng edhe postin e presidentit për vitet e ardhshme. Unë ju thërras që sot të reflektoni!

Ju kemi thirrur që të reflektoni në fillim, kur ka pasur ende kohë, që të tërhiqeni prej dy marrëveshjeve të dëmshme, se vetë shkaktuat probleme të mëdha, të jashtëzakonshme. Ju

thirrëm më vonë kur Gjykata Kushtetuese vendosi më 23 dhjetor dhe dha opinionin e saj që ju jeni shkelës të Kushtetutës dhe që marrëveshjet janë jokushtetuese, por ju përsëri vazhduat që nënkupton që nuk jeni aspak të interesuar që të dilni nga kriza dhe që Kosovën ta nxjerrim nga kjo situatë. Përkundrazi jeni të interesuar që të shkaktoni trazira, sot në kulm të institucioneve keni vënë snajperistë dhe ky është turp për juve - në Kosovën e lirë dhe të pavarur po insistoni që të zgjidheni me dhunë. I keni kthyer masat policore në vend, po i keqtrajtoni edhe këta policë, për të cilët nuk keni krijuar as sigurim shëndetësor, as rroga të mirëfillta, as përkrahje. Ju këta po i shfrytëzoni për ta rrahë popullin dhe qytetarët e vet.

Dhe, kjo është e pafalshme, nuk do t'ju falet as sot, dhe as nesër. Nëse deputetët sot gabojnë, e unë shpresoj që ende ka kohë të reflektojnë, sidomos deputetët e LDK-së, dhe mbyllet ky proces - vendi do të shkojë në zgjedhje dhe qytetarit do t'i kthehet e drejta që të vendosë mbi interesin e Kosovës dhe mbi interesin e vet.

Ju në këtë vit, në vitin e fundit, bashkë Isë dhe Hashim, keni vepruar dhe keni vendosur në interesin e Serbisë. Serbia vazhdon të ketë pozicion armiqësor ndaj Kosovës. Nuk e njeh, nuk ka kërkuar falje për krimet, të cilat i ka bërë, nuk është e gatshme të bashkëpunojë dhe t'i normalizojë marrëdhëniet ndër fqinjësore, prandaj ndaluni se askush nuk ua ka borxh, e aq më pak populli.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Lista serbe? Nuk dëshiron fjalën. Grupi Parlamentar "Nisma", zoti Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Të nderuar qytetarë,
Kolegë deputetë,
Hashim, a po të duket që është festive kjo jashtë?! Kësisoj ke dëshirë të bëhesh president!

Mua më vjen shumë keq, Hashim Thaçi, në mesin e qytetarëve që janë duke kundërshtuar ka shokë të luftës, ka fëmijë të dëshmorëve, ka njerëz që kanë lënë gjymtyrët për këtë vend dhe ti personalisht bashkë tash me çanaklëpirësin tënd, dikur të Rrahman Morinës, je duke e krijuar një atmosferë, një gjendje lufte përsëri në vend. Ju nuk e meritoni të jeni president i vendit, sepse gjatë kohës sa ju keni qenë kryeministër kanë lulëzuar krimi dhe korrupsioni.

Në momentin kur afera "Pronto" ka dalë publike, çdo gjë me ju ka mbaruar. Çdo rezistencë e mëtutjeshme është e kotë. Kapja e shtetit është në të gjitha segmentet. Shkolla, e cila e ke instaluar nëpër institucione, si lokale, si qendrore, është dëshmia më e mirë se kush jeni dhe sa e doni këtë vend.

Ke me qindra struktura tuaja, disa kryetarë komunash të shkollës suaj që janë dënuar dhe janë në procese gjyqësore. Me këtë background mendoni që ta prezantoni edhe vendin. Ju gjatë qeverisjes suaj e keni shkatërruar shëndetësinë, arsimin e keni përdhosur skajshmërisht, administratën e keni politizuar dhe e keni vënë në shërbim të para politikës tuaj. Ju, duke qenë neglizhent në të gjitha segmentet e jetës, duke kapur organet më vitale të vendit - drejtësinë, nuk keni lënë që ky vend të ngre krye dhe ju me veprimet tuaja e keni sjellë edhe Gjykatën Speciale, ku po tentohet të barazohet lufta e lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me barbarinë e regjimit të Serbisë.

Zoti Hashim Thaçi, dialogu me Serbinë është kulminacioni i asaj se pse ju nuk duhet të jeni president. Në kohën kur në Vjenë është biseduar me Serbinë se si të ndahet Kosova dhe të shpallet shtet i pavarur, ju në Bruksel jeni duke biseduar dhe keni bërë marrëveshje si ta ktheni Serbinë në Kosovë dhe është evident projekti tashmë, pas shumë marrëveshjeve të dëmshme, që quhet “Zajednica”, me çka po mendoni ta bosnjëzoni Kosovën dhe nëpërmjet “Zajednicës” Kosovën ta lini shtet jofunksional dhe brenda një jofunksional ju dhe ata që qëndrojnë pas jush, e dini mirë se çfarë synimi keni, sepse në një shtet jo funksional lulëzon krimi dhe bandat mafioze, dhe ju kësisoj mendoni të mbijetoni në jetën publike dhe institucionale.

Ju, më në fund, duke qenë vartësi i Isa Mustafës jeni kampion i dështimit politikës së jashtme, prandaj thirrëni ndërgjegjen në rast se ju ka mbetur pak ndërgjegje. Dil publikisht dhe thuaj se unë, me gjithë këto të zeza që ia kam bërë vendit, nuk mund të jem president i vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Tërmkolli, është replikë apo diskutim? Mund menjëherë replikë, për diskutim i keni dhjetë minuta, ky është dallimi. Fjalën e ka zonja Tërmkolli.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Të nderuar të pranishëm,

Unë sinjerisht nuk kam qare pa folur se kjo vazhdimisht një tërheqje paralele ndërmjet vitit 1989 dhe sot në vitin 2016, kjo është shumë e papranueshme.

Veç pak! Unë e di çka ka qenë ‘89-ta, e ju lidhje s’keni me këtë punë. Viti ‘89 ka qenë raporti ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e sot jemi më 2016. Kosova është shtet i pavarur, mos harroni, që nuk po doni ta pranoni dhe s’po e pranoni, fatkeqësisht. Atë gjak për të cilin ju po flisni, nuk jeni duke e pranuar se Kosova është bërë shtet i pavarur. As s’e pranoni shtetin, as s’i pranoni simbolet, as s’pranoni kurrëgjë! Sot qëndrimi ynë është me Amerikën, a me Rusinë? Ne jemi me Amerikën!

(Duartrokitje)

Ju sot keni thënë, s’po dua të bëj polemika, nuk po përmend emër, që shqiptarët nuk e duan Amerikën. Tmerri i tmerreve ore çka flisni! Po ku ka shqiptar, jo veç në Kosovë, kudo në botë, që nuk qenka me Amerikën, me krejt botën demokratike, sepse baza e demokracisë në këtë Evropë, në këtë botë, janë në rrënjët dhe në themelet e këtij vendi dhe të këtij populli. Nuk mund ne të mos jemi me Amerikën, sepse Amerika është me ne. Mbylle ore, e mos fol!

Sot, a jemi me shtetin, a jemi me kaosin? Ne jemi me shtetin. Nuk po dua të merrem me individë. Ne jemi me shtetin! Ne nuk jemi me kaosin. Me këtë shtet të pavarur dhe demokratik, për të cilin e kemi dhënë jetën, kemi sakrifikuar plot 100 vjet. Mos e rrënoni këtë shtet se kurrkush nuk ka të drejtë ta rrënojë këtë shtet dhe po më flisni ju sot për votat që LDK-ja po e bëka Hashimin president. Veç pak, dëgjoni! Durim, të mirat vijnë pastaj.

Rugova! S’po përmend emra, se s’po dua të bëj polemikë. Ibrahim Rugova i ka dhënë krejt votat e LDK-së, 47 deputetë të LDK-së që ta bëjnë kryeministër dikë të një partie politike me 7 deputetë për tre vjet, vetëm për të funksionuar shteti, të funksionojë Kosova si shtet dhe

dashakëqijjtë, s'po dua të them as armiqtë, të mos mendojnë që shqiptarët nuk dinë të mbajnë shtet. Ne dimë të mbajmë shtet dhe kemi për të mbajtur shtet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Tërmkolli! Replikë, kush dëshiron? Daut, urdhëro!

DAUT HARADINAJ: Faleminderit!

Po i dëgjoj disa kërkoma këtu. Faleminderit Melihate, më vjen mirë për qëndrimin tënd. Shumë mirë më vjen! Më vjen mirë që në -27 gradë ftohtë kur e keni varrosur Rugovën, këtu i keni njerëzit, që ua kanë lënë mbi dhe.

Ku e keni pasur Gardën Kombëtare atë ditë? Ku e keni marrë, a e di? Ku është Agim Çeku, komandanti? Le të flasë. Thuaje Nur! Çka ke thënë atë ditë, thuaje hapur, thuaje publikisht. Mos fyeri këtu...

KRYETARI: Ju kisha lutur për qetësi, dëgjojeni njëri-tjetrin, secili ka të drejtë të flasë.

DAUT HARADINAJ: Jo, hyjmë rend me emra që doni të flisni për atë punë, nuk është telashe. Nuk kam kurrëgjë kundër këtij njeriu, por nuk është president i unitetit. Ju po thoni do ta zgjedhim president, por jo historik. Zgjidheni president, keni për t'u ballafaquar prapë me popull. Se a keni dhënë tokë, po thonë livadhe private. Nuk janë telashe livadhet private, ish-kryeministër. Kam dhënë edhe vëllezër, japim prapë në qoftë nevoja për këtë vend, por nuk është lufta për territore private. Gabim e ke nëse mendon ashtu. Nëse do ashtu, hajde tokën e babës ta jap në Gllogjan, e nëse jam aq i pasur, e kam gjithë atë territor tokë, mbajeni mend, po flasim për mbi 8 800 hektarë. As nuk po ju vjen marre të thoni që është toka e Ramush Haradinajt? Po e mbron livadhin!

Nuk është e vërtetë. Keni nënshkruar gabimisht. Pranojeni! Agim, thuaje shqip se jeni prej andej, ngrihuni deputetë të Dukagjinit, tregoni që ai territor, Kulla e Zhlebit ka qenë kufiri. Çakorri ka qenë kufiri. Ku është vrarë babai i Ibrahim Rugovës, Ukë Rugova? Thojeni me zë, të mos ju vijë marre! Nuk po thotë kurrkush mos e votoni Hashim Thaçin, votojeni lirisht. Pse nuk e bindët Listën serbe që ta transformoni FSK-në në ushtri?

Adem, ke qenë në Kryesi. Hapur e kam pyetur Ismet Beqirin, a jeni marrë vesh me Listën serbe për ta transformuar FSK-në në Forca të Armatosura. I njëjti njeri që dëshiron të bëhet president thoshte “pengesat e opozitës nuk po e lënë të bëhet ushtri”. Nuk ka shtet pa ushtri. Nuk ka shtet, nuk jemi shtet. Gabim e keni, thoni çka të doni. Çka i ofruat Listës serbe sot që erdhën në sallë?! E di! Ma merr mendja, afrojeni prapë llokume. Keni thënë “Gjykata Speciale është e mirë për Kosovën”. E kemi torturuar miletin tonë duke folur gjithë ditën e gjatë. Sot gjysmën e shokëve tanë që i kemi pasur këtu, bashkëluftëtarët tanë, Rafet e di mirë, i kemi në burg, me Sylën, me Samiun, me vëllezërit Kiçina, rend në Drenicë. Ju po thoni do ta thërrasim popullin që të manifestojmë, të gëzohemi që po zgjidhet president Hashim Thaçi.

Nuk është telashe, thirrëni! E di që je duke e festuar, shko festo edhe pyete Samiun qysh është duke festuar se ai të kallëzon. Tek e fundit, nuk është fundi i botës edhe nëse zgjidhet Hashim Thaçi president, por mbajeni mend kurrë nuk do të jetë president i unitetit kombëtar, kurrë nuk do të jetë president i popullit të Kosovës. Do të jetë president i këtij koalicioni.

Dhe, ju si deputetë, qysh do që e keni vendosur t'ia hidhni votën, mbajeni në mend edhe një gjë: Jeni duke e shkatërruar vendin, jeni duke e fundosur. Flitni! Nuk na e keni dorëzuar ende atë CV, por dëgjova çfarë CV-je keni shkruar për kandidatët për president. Mos ia vini kurorën mbretërore se e keni gabim. I njëjti njeri mund ta qeverisë Kosovën për dy mandate. Nuk i duhet asgjë Hashim Thaçit sot posti i presidentit kur sot është mbushur sheshi kundër një individi, kushdo qoftë ai. Po i dëgjoj edhe diplomatët ndërkombëtarë që po thonë “dhuna, ç'dhuna”. Le ta dinë edhe këta zotërinjtë këtu që janë të pranishëm, kush e solli dhunën në Kuvend, se nuk na dëgjuat. Nuk dëshiruat të dëgjoni për ne. U munduam me letra, i shkruam asaj nuses së kombit Jahjaga me dhjetëra herë. I shkruam kryeministrit, i shkruam zëvendëskryeministrit, i shkruam ministrit të Punëve të Brendshme, asnjë përgjigje, qoftë edhe një sms-së nuk e kthyen mbrapa. Na detyruan të përdorim ujë, na detyruan të përdorim gaz, na detyruan të dalim në rrugë, na detyruan të mbarojmë tenda që t'i bindim që e kanë bërë gabim. E kjo nuk ka lidhje me politikë, sepse, tek e fundit, diplomatët vijnë e shkojnë, e vendi ynë do të mbetet këtu.

Nuk po them që do të kthehet Serbia në Kosovë. Kurrë Serbia s'do të kthehet në Kosovë. E ka humbur njëherë e përgjithmonë më 12 qershor. Jemi të vetëdijshëm për at punë, por të mos e instalojmë ligjërisht Serbinë në Kosovë, se më e fortë sot janë Serbia dhe Rusia në Kosovë se në kohën e Milosheviqit, përpos që nuk ka tanke. Tek e fundit, ne duhet të jemi të vetëdijshëm të gjithë, edhe ju që keni vuajtur nëpër burgje, edhe ti Azem, edhe ti Adem, edhe ti ish-ministër i Punëve të Jashtme, se thatë “ka UNESCO, s'ka UNESCO, do të anëtarësohemi, s'do të anëtarësohemi, ka liberalizim, opozita e pengoi liberalizimin”. Cili ishte ai kriter i cili e pengoi opozita? Le të na e thonë të gjithë.

Por, më i rëndësishëm është uniteti i kombit se sa individi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Adem dëshiron fjalën, a? Ka kërkuar si replikë. Do të shkojmë me diskutues, megjithatë mos i ndërhyri njëri-tjetrit, lëreni ta përfundojë.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Nuk e kisha ndërmend absolutisht të flas, sepse s'kam çka të flas. Kam menduar që vërtet kjo ditë do të kalojë ashtu siç e meriton të kalojë një ceremoni, , por më nxitën disa pyetje që u bënë dhe unë po e them me përgjegjësi të plotë: Jam deklaruar dhe deklaroj se ashtu siç ka thënë edhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës - asnjë pëllëmbë e tokës së Kosovës nuk do t'i jepet askujt. Dhe, kjo është e qëndrueshme, është e besueshme, dhe i qëndrojtë prapa.

Këtë e ka vërtetuar më së miri edhe përfaqësuesi i një shteti mik siç është Mali i Zi, që e tregoi gatishmërinë e plotë që ne jemi të gatshëm ta rishikojmë atë marrëveshje nëse janë lëshuar gabime. Prandaj, ky është vetëm një pretekst, është një demagogji që të bëhen përpjekje për të manipuluar me qytetarët e Republikës së Kosovës. Edhe kërkesa për Asociacion ka qenë dashur të debatohet këtu dhe ne në vazhdimësi, edhe sot, në emër të Grupit Parlamentar, u bëj thirrje të gjithëve - ejani të debatojmë këtu. Këtu është vendi i debatit. Nuk kemi nevojë për dhunë. Qytetari i Kosovës ka përjetuar mjaftë dhunë. Nuk e do dhunën. I kemi plagët e hapura.

Prandaj, ne u bëjmë thirrje ejani këtu. Këtu është vendi i debatit. Këtu ne e përfaqësojmë vullnetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Këtu ne i mbrojmë interesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Jo duke bërë përpjekje për të manipuluar dhe për të shkaktuar dhimbje.

Unë e thashë dhe po e them se është kënaqësi shumë e madhe që ne sot ia propozojmë këtij Kuvendi kandidatin më të mirë, më të qëlluar dhe të domosdoshëm për Kosovën në këto rrethana, që ai të jetë president i vendit. Që e ka përfaqësuar vendin tonë në periudhat më të vështira që ka kaluar ky shtet dhe asnjëherë nuk është strukur, por e ka dhënë kontributin e vet në çdo kohë dhe në çdo periudhë me atë që është kërkuar, e që do ta japë edhe nesër.

Ne kemi nevojë për njerëz të guximshëm, për njerëz të dijshtëm, për njerëz të dëshmuar dhe të gjitha këto vlera janë tek Hashim Thaçi, prandaj ne u bëjmë thirrje ju të gjithëve që ta japim votën dhe shteti ynë ta ketë kandidatin e domosdoshëm. Është e vërtetë se Hashim Thaçit më së paku i nevojitet të jetë president, por Presidenca, ky shtet dhe ky popull ka nevojë për Hashim Thaçin dhe Hashim Thaçi është dhe do të jetë në shërbim të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit, zoti Grabovci! Jemi në radhën e diskutuesve. “6+”, e dëshiron fjalën. Atëherë deputetët sipas radhës së paraqitjes. Meqë unë e kam marrë një listë, në qoftë se dëshironi t’i përmbaheni, kërkojeni fjalën në mënyrë elektronike, apo dëshironi me listë. Ismajl Kurteshi, urdhëro!

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Përshëndetje qytetarëve të Kosovës,

Para se të flas për atë që jam përgatitur, e kam një pyetje për ju kryetar i Kuvendit: Bazuar në ftesën, ne sot këtu kemi ardhur, ju e keni thirrur një seancë për zgjedhjen e presidentit, e jo të votojmë për ose kundër Amerikës, sepse qytetarët e Kosovës, shqiptarët kudo që janë, herët kanë votuar për këtë çështje dhe e kanë përcaktimin e tyre, prandaj këtu nuk kemi nevojë për fjalime, siç ishte ai i Tërmkollit, dhe të tjerëve, por do të duhej që vërtet sot të koncentrohemi këtu ku jemi, sepse ne jemi që Amerikën ta kemi partner dhe në miqësi me të.

Si do që të jetë, në këtë situatë të krizës së thellë politike, të shkaktuar nga kryeministri dhe zëvendësi i tij, është që të gjithë të angazhohemi për dalje nga kjo krizë e shkaktuar nga krerët e koalicionit qeverisës. Por, këta që kanë për synim, njëri zgjatjen e mandatit të tij si kryeministër, e tjetri avancimin që të dalë në krye të shtetit nuk po e dëgjojnë zërin e arsyes, zërin e popullit, i cili po kërkon që në këtë situatë të gjithë të merremi me zgjidhjen e krizës, e jo me zgjedhjen e presidentit.

Thaçi, nëse për asgjë tjetër, nuk do të duhej të zgjidhej president, vetëm për deklaratat luftënxitëse dhe fyese që ua ka bërë qytetarëve të fundit brenda javës së fundit. Ai nuk do të duhej të zgjidhej president për mashtrimin që ua ka bërë qytetarëve të Kosovës në vazhdimësi gjatë këtyre 16 vjetëve, duke filluar që nga decentralizimi në baza etnike, kur deklaronte diçka tjetër në opinion, e ne që ishim afër tij thoshte se decentralizimin do ta zhbëjmë menjëherë pas shpalljes së pavarësisë. Dhe, në vend që të zhbëhej decentralizimi lindën e u nënshkruan edhe shumë marrëveshje të dëmshme për këtë vend dhe erdhi deri te shkelja e Kushtetutës për të cilën shkuan dy presidentë më herët, e tani dikush po do të bëhet president, i cili paraprakisht e ka shkelur Kushtetutën. Kjo vërtet nuk mund të merret me mend.

Ai nuk duhet të zgjidhet president për shkak të pasurimit të madh të tij dhe kostos së tij, dhe të varfërimit të skajshëm të qytetarëve të Kosovës, e jo pasurim të ndershëm dhe me punë, por

pasurim me vjedhje të buxhetit dhe të xhepave të qytetarëve të këtij vendi. Ai nuk duhet të zgjidhet president, sepse në shkollat tona e ka legjitimuar analfabetizmin dhe në të gjitha institucionet ka zbehje dhe zhbërje të tyre. Por, për t'i numëruar të gjitha arsyt pse nuk do të duhej të zgjidhej president do të duhej një kohë jashtëzakonisht e gjatë, ato po i numërojnë një nga një qytetarët jashtë, të cilët po e kundërshtojnë zgjedhjen e presidentit, por besoj që nëse sot nuk i dëgjoni do t'i dëgjoni nesër, dhe vendi patjetër do të lirohet nga një udhëheqje kaq e papërgjegjshme e këtij vendi.

Unë i kam dy fjalë që t'i drejtohem Listës serbe. Ata duhet ta kuptojnë se Kosova nuk është as e Isës, e as e Hashimit. Çka do që u kanë premtuar Isa dhe Hashimi sot, ato nuk do të realizohen, sepse zot i këtij vendi janë qytetarët e Kosovës. Të ardhmen tuaj e keni nëse uleni dhe bisedoni me përfaqësuesit legjitimë të këtij vendi, të cilët sigurisht do t'u garantojnë barazi, liri, jetë të qetë dhe të lumtur në Kosovë. Derisa të angazhoheni për realizimin e politikave hegjemoniste të Serbisë, ju do të jeni mjet i Serbisë për t'i realizuar ato synime që kurrë më nuk do të realizohen në Kosovë dhe të atyre karrieristëve, të cilët edhe nëpërmjet jush përpiqen t'i kapin pozitat të cilat nuk u takojnë.

Në fund i ftoj të gjithë deputetët, të cilët kanë përgjegjësi për të ardhmen e këtij vendi që sot të mos e votojnë Hashim Thaçin për president të vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kurteshi! Fjalën e ka Fatmir Limaj.

FATMIR LIMAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryetar i Parlamentit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po të ishte vendi në rrethana normale, sot do të ishte, nëse jo krejt festuese, të paktën do të ishte një seancë normale.

Dhe, ashtu siç ka ndodhur se nuk është rasti i parë ky që ndodh në Kosovë, kur zgjedhjet asnjëherë nuk i plotësojnë objektivat dhe dëshirat e të gjithëve, por kur situatën e kemi normale dhe brenda standardeve demokratike dhe një klimë normale të pranueshme të qytetarët, kështu bashkëjeton demokracia. Dikush pajtohet dhe dikush s'pajtohet.

Sot, të nderuar kolegë, jemi në një situatë jonormale, në një situatë shumë të vështirë, në një situatë krize të thellë politike në vendin tonë. Deri më sot, Parlamenti i Kosovës nuk ka pasur rol në thellim të krizës, ose në krijimin e krizës. Deri më sot Parlamentit të Kosovës i është imponuar njëfarë situatë, situatë të pakëndshme të cilët i kemi parë për këta muaj, pa fajin e tij. Sepse, shkaktari i krizës dhe gjithë atyre skemave pastaj që kemi bërë në Parlament ka qenë Qeveria.

Parlamenti i Kosovës sot është para një sfide të madhe. Fatkeqësisht për ne këtu që jemi, ky Legjislativ, këtë vit kemi pasur 2-3 sfida. Rrallë ndodh në një Parlament të ketë sfida kaq të mëdha në mandatin e tij. Parlamenti i Kosovës sot është para një sfide që t'i japë zgjidhje krizës, apo ta thellojë krizën në vend, dhe sot Parlamenti i Kosovës do të futet në rolin e vet dhe do ta marrë përgjegjësinë. Deri sot nuk ka qenë përgjegjës. Nga momenti i sotëm, Parlamenti i

Kosovës e ka një moment, e ka një rast ta nxjerrë vendin nga kriza, apo ta thellojë krizën. Dhe, këtu përgjegjësinë e kanë të gjithë deputetët e këtij Parlamenti.

Unë vazhdoj të qëndroj në bindjen time se ky Parlament e ka humbur legjitimitetin e vet demokratik dhe se ka nevojë të shkojë të testohet te qytetarët. Dhe, ky Parlament, në sekondën e fundit, për hir të interesave të vendit, do të duhej të dilte në krye të detyrës. Përdërisa nuk ka mundur të zgjidhet kriza aty ku është dashur të zgjidhet, atëherë Parlamenti sot ta marrë veprimin e vet dhe t'i japë rrugëzgjidhje kësaj krize dhe ta nxjerrë vendin nga kriza. Dhe, zgjidhjen e krizës, Parlamenti i Kosovës sot mund ta bëjë nëpërmjet kësaj pike të rendit të ditës, duke çuar vendin në zgjedhje.

S'është me rëndësi për a kundër. E rëndësishme është që e ka një moment juridik e ligjor ta çojë vendin në zgjidhje, sepse s'i ka mbetur fushë e veprimit dhe e manovrimit dhe se me një votim nuk zgjidhet kriza.

Të nderuar kolegë,

Ne të gjithë sot duhet të jemi të vetëdijshëm që në qoftë se procedojmë me zgjedhjen e presidentit të Republikës, deputetët e Parlamentit të Kosovës bëhen aktorë dhe e marrin përgjegjësinë për thellimin e mëturjes të krizës në vendin tonë. Nga sot, në qoftë se procedohet me zgjedhjen e presidentit, Kosova do të futet në një krizë edhe më të thellë.

Deri sot, të gjithë e dimë se në çfarë gjendje kanë qenë institucionet, të kontestuara. E kemi një regjim të një Qeverie e cila e ka shkelur Kushtetutën, e mban pushtetin nëpërmjet aparatit represiv dhe vazhdon ta mbajë. Këta mendojnë që mund ta mbajnë deri më 2018. Kurrë kurrkush se ka mbajtur ashtu, s'kanë për ta mbajtur as këta. I vetmi institucion që ka qenë legjitim e legal dhe një pikë shprese që është munduar ta ruajë unitetin dhe bashkëpunimin, një urë të komunikimit ndërmjet palëve ka qenë institucioni i Presidentit të deritanishëm. Dhe, presidenti i deritanishëm, me të gjitha mundësitë e veta, me vullnetin e vet, është munduar ta luajë një rol.

Nga nesër, në qoftë se ky Parlament voton për presidentin, edhe institucioni i Presidentes do të kapet nga kriza, sepse edhe në krye të institucionit të presidentit do të dalin përfaqësuesit, të cilët janë zënë në shkelje të Kushtetutës. Domethënë, nga sot pasdite, ose nga nesër, Kosova më nuk do të ketë as Parlament legjitim, për Qeveri dihet, por do ta kemi edhe presidentin i cili ka qenë në shkelje të Kushtetutës, sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Dhe, kjo është ajo që thashë, thellim i krizës dhe më nuk do ta kemi asnjë institucion i cili do të mund ta luajë rolin e daljes nga kriza.

Të nderuar kolegë deputetë,

Këta gjashtë muaj Kosova është sfiduar. E dimë të gjithë, kemi parë skena të pakëndshme, të papranueshme për asnjërin. Kryetari i Kuvendit të Kosovës në përputhje me Rregulloren e Kuvendit dhe me Kryesinë, duke u thirrur në respektimin e Rregullos së Kuvendit, ka përjashtuar anëtarë të Parlamentit, ka urdhëruar të hiqen deputetët zvarrë nga seanca plenare. Në rregull! Rregullorja ia ka mundur. Por, shtrohet pyetja: Si është e mundur të respektohet Rregullorja e Kuvendit dhe të bëhet krejt ajo çfarë është bërë, ndërsa shkelësit e Kushtetutës të shpërblehen?! Sot, këtu kanë marrë masa, burgosje, arrestime, arrestime shtëpiake, e çka jo, zvarrë deputetët, për shkelje të Rregullos!

Pajtohemi, a nuk pajtohemi, ajo Rregullore është respektuar. Dikush mund të pajtohet, dikush mund të mos pajtohet, por, në fund të fundit, është sipas Rregullores. Por, shtrohet pyetja tjetër: Si është e mundur që njerëzit që e kanë shkelur Kushtetutën të shpërblehen? Për çka shpërblehen? A ka ndonjë vend në Evropë, a në botë, ku shpërblehet një njeri që e shkel Kushtetutën paraprakisht. Kjo po ndodh sot, të mos e bëjmë këtë, të mos e kthejmë debatin në çështje personale, por ta kthejmë në atë çka ne besojmë, një pikë shpresë, një moment që ne e kemi një mundësi t'i japim zgjidhje krizës së këtij vendi dhe të ecim përpara.

Natyrisht, që një parti e madhe sipas ligjit e propozon kandidatin, ashtu siç e kërkon procedura, të pëlqeu, s'të pëlqeu, është çështje e tyre. I ka votat, i ka nënshkrimet dhe deri këtu krejt është procedura normale legale. Problemi është diku tjetër, a e përfaqëson votimi i secilit deputet vullnetin e qytetarëve të Kosovës? Nuk është njëjtë si zgjedhja e Qeverisë, si zgjedhja e presidentit, dhe ju të gjithë e dini mirë këtë çështje. Nuk është njëjtë sikur koalicionet paszgjedhore, sikur përzgjedhja e kandidatit për president. Nuk është njëjtë. Janë dy çështje të ndryshme.

Prandaj, shtrohet pyetja: Në qoftë se, një kandidat i ka 30% mbështetje të qytetarëve të Kosovës, domethënë i mungojnë 70% mbështetje të qytetarëve të Kosovës. Dhe, secili deputet, natyrisht, sipas ndërgjegjes dhe bindjes së tij të lirë, do të duhej të reflektonte përmes votës së tij vullnetin e votuesit të vet dhe mbi bazën e saj të votojë.

Në qoftë se, shkojmë kështu e ta reflektojmë vullnetin e votuesve, atëherë jam i sigurt se nuk përfaqësohet vullneti i votuesve me zgjedhjen e këtij presidenti. Besoj që jemi të qartë. Por, në fund të fundit, përsëri po them, është përzgjedhje e secilit individualisht dhe secili merr përgjegjësi për veprimet e veta.

Të nderuar kolegë,

Ajo që unë po them, është se e kemi një moment të rëndësishëm përtej përzgjedhjes, përtej fatit të individit, përtej përzgjedhjes së një kandidati, e kemi fatin dhe mundësinë e artë për ta zgjedhur krizën apo për ta thelluar atë. Nëse duam të gjejmë rrugë për zgjidhjen e krizës, ky është momenti, pasi që s'ka mundur të bëhet përmes tryezave, Parlamenti mund të vihet në krye të detyrës dhe përmes refuzimit të presidentit të shkohet vendi drejt zgjedhjeve, ashtu siç e jep Ligji, dhe pastaj të gjithë shkojmë ta rikonfirmojmë legjitimitetin dhe kjo situatë njëherë e mirë të zgjidhet dhe, ashtu siç vendos vullneti i popullit të respektohet ta respektojmë vullnetin e tij.

Unë shfrytëzoj rastin t'i ftoj të gjithë qytetarët e Republikës, mos lejoni, mos lejoni në asnjë variant, përplasje. Mos lejoni të bini pre e asnjë veprimi të dhunshëm nga asgjë e për asgjë, sepse nuk ia vlen. Vendi ynë sot ka nevojë për paqe, vendi ka nevojë për zgjidhje. Ky parlament e ka detyrë kushtetuese me i dhënë vendit zgjidhje. Zgjidhja, të nderuar kolegë deputetë, sot është që të gjithë mos me e lejua zgjedhjen e presidentit dhe vendin me e çua në zgjedhje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani fjalën e ka Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Sot është thirrur kjo seancë e jashtëzakonshme, në vend se sot të jetë një seancë solemne. Pse është kështu situata? Sepse, këta që janë në pushtet sot e kanë krijuar çdo situatë të jashtëzakonshme në Kosovë, duke dërmuar popullin për të rehabilituar vetveten dhe klikat e veta politike. Këta qeveritarë, të cilët prej se kanë ardhur në krye të Qeverisë nuk janë kategori qytetare pa ofenduar me gjithfarë shprehjesh e akuzash, i shpallën edhe luftë qytetarëve duke u thënë, se “...s’keni guxim të vini, sepse ne ju prisnim”.

E sollën Gjykatën Speciale për të gjykuar luftën e shenjtë të UÇK-së, e zbrazën Kosovën, përmbi 100 mijë qytetarë e kanë lëshuar Kosovën. Ata ikën, se nuk panë shpresë në këtë vend. E sollën ndarjen e Kosovës duke pranuar një shtet brenda shtetit, pa lënë territor të Kosovës në kufi me Maqedoninë dhe me Malin e Zi. Dështuan ta anëtarësojnë Kosovën në UNESCO dhe në organizata të tjera të rëndësishme. Nuk kemi njohje edhe të asnjë shteti tjetër më tutje të Kosovës. Janë mbyllur përmbi 20 mijë biznese të vogla dhe të mesme. Po ia falin dhe po e bëjnë hisedarë Serbinë në pasuritë kryesore të Kosovës me “Trepçën”, Ujmanin, Postën dhe Telekomin e Kosovës dhe të tjera pasuri të qytetarëve të Kosovës.

Dhe, në fund po besoj, sikur edhe shumë e shumë qytetarë, që shkarkimi i kësaj Qeverie dhe moszgjedhja e këtij kandidati për president është gjëja më e nevojshme për Kosovën. Për të shpëtuar Kosova nga kthetrat e Serbisë, kjo është gjëja më e duhur tani për tani. Nëse, ju nuk e bëni sot vetë, do ta bëjë nesër populli, por atëherë nuk dihet se si do t’u shkruhet juve në histori. Dhe, të lutem, mos u thirr në emër të UÇK-së, mos merr merita që nuk të takojnë, sepse po sillesh qysh po të konvenon, herë ke qenë në luftë dhe herë nuk ke qenë. Dhe, a mos je ti pjesëtar i familjes Jasharaj, Haradinaj, Pajaziti, Hoxha, Ramadani, sepse ti “na paske sjellë edhe lirinë, edhe pavarësinë”!

Zoti Hashim Thaçi, ti nuk na e solle as lirinë, as pavarësinë! Lirinë dhe pavarësinë na e sollën dëshmorët e kombit, invalidët dhe veteranët.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Është diçka e veçantë, që nën brohoritjet e masës protestuese ne të flasim këtu dhe t’u drejtohem më shumë atyre, se sa kolegëve deputetë.

Tashmë, masa protestuese, qytetarët e këtij vendi, e kanë thënë fjalën e vet. Do të duhej që në përputhje me mandatin, ta thonë edhe deputetët të cilët janë votuar nga ajo masë. Na mbetet borxh, që të vëmë në vend atë çfarë dikush po mundohet ta shtrembërojë, se “kush është me Amerikën e kush është me Rusinë?!”. Nëse dëshironi ta dini, se kush është me Amerikën, shikoni qytetarët në shesh, shikoni flamujt e tyre, e nëse dëshironi ta dini se kush është me Rusinë, shihni në zyrat e partnerëve tuaj të koalicionit. Por, tani jemi në këtë seancë, jo për ta zgjedhur një president, por për ta mohuar një president. Ky do të duhej të ishte roli ynë. Jo për ta mohuar presidentin, por për ta mohuar një fryt eventual të një mazhorance jolegjitime të një koalicioni dhe Qeverie jolegal.

Legjitimiteti i kësaj mazhorance ka humbur atëherë kur edhe e ka humbur legalitetin Qeveria, qysh në definimin e shkëljes së Kushtetutës nga ana e kësaj Qeverie. Pra, kjo Qeveri është ilegale, e kapur në flagrancë në përmbysje të rendit kushtetues, e ngelur në tentativë dhe, këtë e thotë verdikti i Gjykatës Kushtetuese, jo vetëm ne. Dhe normalisht, që nga një mazhorancë jolegjitime dhe nga një koalicion që ka një Qeveri jolegale, nuk mund të pritet asnjë gjë tjetër, përveç që një president eventual jolegjitim dhe jolegal.

Dua t’jua konfirmoj edhe një herë, që biografia e kandidatit është një biografi e rrejshme. Nuk është kështu, siç thuhet në këtë biografi. Ju na e keni lënë në kutitë tona, por nuk mund të dilni këtu e të na thoni, që Ushtria Çlirimtare e Kosovës, siç thuhet këtu, paska pasur “krah politik”. Kur është themeluar ky krah politik? Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka pasur Drejtori Politike, jo krah politik, aq më tepër, siç thuhet këtu, që nga viti 1997 - 1999.

Po e marr vesh për herë të parë, që ky kandidat paska qenë edhe lider i Lëvizjes Studentore, që s’e kam ditur, nuk është dashur të na fshihni më herët. Dhe po ashtu, thuhet që qenka bashkëthemelues i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Le të na e thonë kolegët tjerë këtë fakt, në ekziston kështu apo jo. Por sidoqoftë, unë do të kthehem edhe një herë te profili i kandidatit. Ky njeri për shumë gjëra tjera, por edhe për faktin që është një njeri jounifikues, nuk do të duhej të ishte kandidat për president. Ky e di që këtë parakusht kushtetues nuk e përmbushë. Ky njeri, po ashtu, kërkon që të jetë unifikues i qytetarëve të Kosovës, të cilët i kërcënon që “nuk do t’i priste veç me kafë”. Me çfarë do t’i prisje, zoti ish-kryeministër?

Po ashtu, kërcënimet na erdhën edhe sot, se do thërrasë njerëz simpatizantë të Partisë Demokratike të Kosovës, që të vijnë këtu e të bëjnë një antimiting. Normalisht, se të gjithë këta qytetarët përreth nesh, nuk kanë rënë pre e këtyre kërcënimeve, normalisht se nuk kanë frikë, normalisht se edhe nuk presin që anëtarët dhe simpatizantët e Partisë Demokratike të Kosovës do të vijnë e të luftojnë, siç ju mendoni, për ty. E shumica prej tyre, normalisht që janë të thirrur që të vijnë nga zonat nga vijmë ne të dy bashkë, nga Drenica.

Drenica nuk të mbron kur ti e ke keq! Drenica nuk të mbron, sepse ti s’ua mbrojte kryetarin e komunës, i cili sot është në burg! Drenica nuk të mbron ty, sepse nuk ua mbrojte komandantin e përgjithshëm të UÇK-së, i cili sot është në burg, e është në burg bashkë me shumë të burgosur të tjerë, siç është edhe kryetari i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, zoti Glauk Konjufca.

Meqë bëhet fjalë për Drenicën, jo rrallëherë ky njeri është thirrur në këto vlera. Edhe unë vij nga ajo zonë. Unë dua të them, që unë të dua ty për president, po aq sa të do edhe familja Jashari. Besoj, se të mjafton! Nuk mund të them, që të dua siç të desh Adem Jashari, sepse do ta merrje si kërcënim. Zgjedhja e këtij njeriu nuk e zgjedh krizën, e thellon krizën!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Hoti.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!
Të nderuar deputetë,

Sot në vend se vendi të ishte në festë, ne jemi këtu në sallën e Kuvendit duke proceduar me procedurën e për zgjedhjen e presidentit dhe njëkohësisht duke iu nënshtruar thirrjes së qytetarëve, që kjo procedurë të refuzohet dhe të hiqet nga rendi i ditës.

Dhe për vetë faktin, sepse qytetarët e kanë një pyetje e atë pyetje po e sjell unë këtu. Jemi duke votuar presidentin e 17 shkurtit 2008, apo presidentin e 28 gushtit 2015?! Kosova nuk është e njëjtë me atë marrëveshje, prandaj me të drejtë qytetarët e shtrojnë këtë pyetje, shtrojnë pyetje lidhur me Kosovën e 17 shkurtit 2008 me një demarkacion dhe në kufijtë që i kishte apo me demarkacionin, i cili është nënshkruar pikërisht nga kandidati që po pretendon të zgjidhet president i vendit.

Përpos tjerash, ky njeri vendosi që për shkaqe të veta të eliminojë njerëz atdhetarë nga skena politike dhe të ofrojë ish-strukturat e ish-sistemit, gjë që edhe më tepër e rëndon kandidaturën dhe e rrezikon edhe më tepër si gjendje, që mund të jetë në të ardhmen. Po ashtu, si rezultat i keqqeverisjes së tij erdhi deri tek formimi i Gjykatës Speciale, erdhi deri te burgosja e njerëzve të luftës dhe po ashtu, nga njerëz të cilët i kanë përgatitur dosjet edhe këtij edhe njerëzve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, tani po pretendon me votën e tyre të bëhet president. Vendi po kalon një krizë të thellë, një polarizim ekstrem, pikërisht për fajet e këtij njeriu, prandaj është momenti i fundit, siç u tha edhe nga parafolësit, që t'i jepet zgjidhje politike. E zgjidhja jepet duke refuzuar procedimin e mëtutjeshëm të zgjedhjes së presidentit të vendit. Unë ftoj qytetarët, që të kenë kujdes dhe të mos bien pre e skenarëve dhe kërcënimeve të ndryshme, të cilët i kemi parë edhe më herët. E dimë se si mund të veprojnë dhe si mund të futen në situata, sepse këta njerëz mbijetuan dhe pretendojnë të mbijetojnë vetëm mbi kriza, nga krizat erdhën dhe nga krizat, një ditë, do të shkojnë. Faleminderit të gjithëve për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ilir Deda. Nuk do? Atëherë, fjalën e ka zonja Teuta Haxhiu. Më fal Teuta, se të kam kaluar parëz!

TEUTA HAXHIU: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, Është vërtetë e habitshme dhe madje, e paimagjinueshme se si Hashim Thaçi, tashmë i inspiruar edhe nga shefi i tij Isa Mustafa, ka zgjedhur që me çdo kusht të pretendojë të ulet në kolltukun e presidentit, duke shkelur çdo normë e çdo mjet, madje edhe mbi gjakun e bashkëkombësve të tij, nëse e kërkon nevoja.

Ky është turpi i skajshëm, ky është mjerim, të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës!

Haxhim Thaçi, mbase do të ishte i fundit nga partia e tij, që do të duhej të pretendonte të ishte president i Republikës së Kosovës. Ai nuk është një person unifikues, i cili do të paraqesë unitetin e popullit të Kosovës, ashtu siç e parasheh Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Përkundrazi, ai është një person krejt i papranueshëm për këtë pozitë. Haxhim Thaçi me vendimet e tij do të paraqiste shembullin më të neveritshëm të njeriut të parë të Republikës së Kosovës. Për këtë kemi me qindra dëshmi gjatë karrierës së tij politike, të cilin zaten ndër vite e ndërtoi mbi kurriz të të tjerëve dhe popullit të tij të shumëvuahtur. Si i tillë ai nuk mund të ofrojë kurrë në një tryezë politike dhe asnjëherë nuk do të mund të arrijë kompromise të nevojshme për interesat jetike të vendit tonë.

Si mund të zgjidhet president një njeri si Hashim Thaçi, kur është në gjendje pa fije turpi të falë tokë të Kosovës, cilitdo vend fqinj dhe të çirret sikurse asgjë nuk ka ndodhur, madje duke deklaruar se Kosova nuk po humbë asnjë centimetër toke. Si mund të votohet, madje të zgjidhet president i Kosovës, një njeri i cili nuk e bën dot dallimin e tokës së Kosovës si pronë private dhe shtetërore, madje duke etiketuar rëndë bashkëqytetarët e vendit dhe kundërshtarët opozitarë. Si mund të votohet a të zgjidhet president i Republikës një njeri si Hashim Thaçi, i cili gjatë gjithë kohës sa ishte kryeministër, shteti ynë është zhytur në krim dhe korrupsion, ndërsa Qeveria është bërë sinonim i shkeljes së Ligjit dhe Kushtetutës.

Nëse, Gjykata Kushtetuese në këto vite ekskluzivisht ishte në shërbim të tij, çfarë mund të presim nga Gjykata, ku një njeri të ishte president i tillë, pra.

Të nderuar qytetarë,

Kuvendi i Republikës së Kosovës në vitin 2011 nxori një Rezolutë, me të cilën obligonte Qeverinë e Republikës së Kosovës që në bisedimet në Bruksel, pra me Serbinë, t'i kushtëzonte me çështjen e të pagjeturve. Sot, Kosova ka edhe 1650 qytetarë të pagjetur dhe asnjëherë nuk ishte temë, dhe asnjëherë nuk kërkoi dhe nuk tentoi që të akuzojë Serbinë për krimet që bëri në njerëzimin tonë, pra në popullin e Kosovës.

Ky njeri vetëm sa i solli dëme Kosovës, i solli vetëm tri njohje Republikës së Kosovës, dështoi në anëtarësimin e Kosovës në UNESCO. Thjesht, të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, si mund të votohet sot protagonistin kryesor i gjendjes së krijuar sot në vendin tonë, vetëm e vetëm që sot të zgjidhet president? Larg qoftë! Sot është momenti që deputetët, ashtu sikur e kanë bërë betimin, pra, të japin verdiktin e tyre, për të dalë nga kriza dhe për të shkuar në zgjedhje të lira dhe pastaj qytetarët le të vendosin se kush do të jetë president. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Deputetë të Kuvendit,

Ne nuk kemi pasur seancë të jashtëzakonshme, as për arsimin, as për shëndetësinë, as për agresionin e strukturave të Serbisë, nuk kemi pasur të jashtë zakonshme as për papunësinë e për varfërinë, por ja që në kuadër të njëfarë "puçi" kundër Republikës po synohet që të kontrabandohet një president i ri, me një seancë të panevojshme të jashtëzakonshme, duke vërtetuar kështu që po keqpërdoren institucionet e shtetit nga udhëheqësit e korruptuar të saj.

Pse duhet që këta njerëz të jenë kaq të befasishëm për Kuvendin dhe popullin dhe kaq të parashikueshëm për kundërshtarët e Pavarësisë sonë. Pra, këta janë tërësisht njerëz të parashikueshëm prej Serbisë dhe në anën tjetër duan të jenë të paparashikueshëm prej popullit të Kosovës, unitetin e të cilit do të duhej ta shprehte edhe pozita e presidentit.

Kosova sot nuk ka nevojë për president të ri nga ky Kuvend i vjetër i gazit, Kosova ka nevojë për zgjedhje të reja parlamentare, meqenëse nuk u lejua referendumi, ka nevojë për Kuvend të ri pas atyre zgjedhjeve të reja parlamentare e më pas, ka nevojë edhe për president të ri, për Qeveri të re, për qeverisje të re.

Nuk u lexua biografia e kandidatëve këtu, që të prezantohen para qytetarëve të Republikës, përveçse ajo u shpërnda nëpër kutitë e deputetëve. Këtu ka shumë pasaktësi, ka shumë të pavërteta, që e bëjnë biografinë e kandidatit, tash zëvendëskryeministër, të rrejshme. Pra, kemi një njeri që e njohim dhe kemi një biografi, që nuk e njohim. Thuhet, që si kryeministër na e paska shpallur pavarësinë më 17 shkurt të vitit 2008, në Kuvendin e Kosovës. Kjo është e pavërtetë! Pavarësinë e Kosovës e kanë shpallur të zgjedhurit e popullit, ndërkaq në mënyrë të çuditshme Deklaratën e Pavarësisë e ka lexuar kryeministri. Pra, bëhet fjalë për një shpifje përbrenda biografisë, por ka edhe të tjera, sikurse kjo që e flet gjuhën angleze. Ne nuk e kemi parë këtë gjë. Ndoshta, nga afëra “Pronto” do të mund të thoshim që flet atë italiane, prej bashkëbisedimit me kolegun e tij Grabovci, kur flasin italisht me njëri-tjetrin, duke thënë “pronto”, “come stae”, sikurse në filmat e Skorsezës, apo Kopolës, duke dashur që të imitojnë mafien italiane.

Pra, ka përplot pasaktësi e të pavërteta në këtë biografi, por ka edhe gjëra shumë më të rrezikshme se kaq. Ta zëmë, thuhet që ky person ka qenë edhe i njohur për angazhimin e tij në Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës, kur dihet që në fundin e viteve të 80-ta njerëzit të cilit ishin udhëheqës të Lëvizjes Ilegale për Çlirim, ishin Fadil Vata, Afrim Zhitia dhe Beadin Hallaqi. Fadil Vata vdiq nga pasojat e torturave dhe sëmundjeve, që mori nga burgu. Afrim Zhitia u vra nga regjimi i Serbisë, ndërkaq mbetet enigmatike zhdukja e Beadin Hallaqit, i cili në njërin anë është shpallur hero i Kosovës, mirëpo në anën tjetër është heshtja e zëvendëskryeministrit, i cili është personi i fundit që ka qenë me të. Nuk tregohet se në cilën luftë, në cilën betejë na paskësh rënë Beadin Hallaqi, i cili më pas u shpall hero i Kosovës. Heshtja e zëvendëskryeministrit, që është president në tentativë, e bën shumë të dyshimtë këtë person, i cili ka qenë i fundit me Beadin Hallaqin, por nuk tregon se çfarë ka ndodhur me të!

Pse, kjo është e rëndësishme? Sepse, Beadin Hallaqi si kokë intelektuale, politike e kombëtare ishte menjëherë pas Ukshin Hotit dhe, dihet që drejtimin e luftës e mbajnë koka të tilla. Dhe, zëvendëskryeministri, që është president në tentativë, ngritjen e tij në karrierë e ka pikërisht duke ju falënderuar devijimeve dhe koncesioneve, jo konsistencës dhe këmbëngulësisë. Ja tri koncesione, apo kompromise të mëdha, apo devijime të mëdha, të cilat kanë bërë që Kosova të bie e ky të ngritet personalisht. I pari është ai i çarmatosjes së UÇK-së, kur dihet që është vështirë të gjendet në histori apo në vendet e tjera ndonjë rast tjetër, ku kanë rënë aq shumë luftëtarë të lirisë, duke u përpjekur të sigurojnë armatimin në kufirin shqiptaro-shqiptar dhe më pas këto armë dorëzohen, çarmatoset UÇK-ja dhe kjo çarmatosje e UÇK-së e ngritë në karrierë këtë person.

E dyta, është braktisja e idealit të bashkimit kombëtar, që figuron në betimin e ushtarit të UÇK-së, në të cilin tekst realisht nuk përmendet as Kosova, as Pavarësia, sepse aspirata dhe vullneti janë për shumë më tepër se kaq. Pra, një koncesion tjetër ky dhe, e treta është kalimi prej orientimit të majtë, le të themi, tek ai neoliberal i privatizimeve të egra. Këto janë ato tri kompromise të mëdha në kurriz të Kosovës dhe kombit shqiptar, që e ngritën një person të veçantë. Dhe, këtu një devijim në thelb të këtyre kompromiseve është pikërisht zhdukja enigmatike e Beadin Hallaqit.

Për ma është e qartë, se synimi i këtij njeriu është që po u bë president, atëherë ta ndryshojë Kushtetutën dhe ta bëjë Kosovën me sistem presidencial, pikërisht të kalohet nga republika

parlamentare në republikën presidenciale, ngjashëm siç po bëjnë autokratët tjerë në Ballkan e në lindje, në përgjithësi. Prej Viktor Orbanit në Hungari, te Vuçiqi në Serbi, te Gjukanoviçi në Mal të Zi, te Gruevski në Maqedoni e deri te Erdogani në Turqi, e Putini në Rusi. Pra, ka një tendencë autokratike, ku diktatura po zëvendësohet me regjimin autoritar dhe dikush pretendon që ta shndërrojë shtetin në pronë private, popullin në familje të vet, së cilës i vendoset si “baba i kombit”. Mirëpo, kjo s’ka të bëjë as me demokracinë dhe as me Republikën.

Parandalimi zgjedhjes së këtij personi për president e parandalon shndërrimin e Republikës së Kosovës në një autokraci anti-demokratike. Natyrisht, që problemi më i madh në këtë aspekt është çështja e “Zajednicës” së Serbisë. Ky është personi që e filloi “Zajednicën”, të cilën e kurorëzoi Mustafa dhe tash e dëshiron kurorën e presidentit si shpërblim për këtë. “Zajednica” e Serbisë në Kosovë është tërësisht e ngjashme për nga procesi dhe rezultatet me Republikën Serbe në Bosnjë. Më lejoni ta sqaroj shkurtimisht me fakte. Bashkësinë e 14 komunave të tyre në Bosnjë, me planifikimin dhe ndihmën e Beogradit, serbët atje e formuan më 26 prill 1991. Më 9 janar 1992 ata e shpallën Pavarësinë, kurse më 28 shkurt 1992 e miratuan Kushtetutën e tyre.

Ndërkombëtarisht kjo iu njoh atyre më 14 dhjetor të vitit 1995, në Marrëveshjen e Dejtonit, pas negociatave të cilat për çështjet e brendshme të Bosnjës, Alia Izetbegoviçi i zhvilloi me Milosheviqin dhe Tugjmanin në Ohajo të SHBA-ve. Ajo që u arrit në Bosnjë dhe Hercegovinë përgjatë luftës e me luftë, për 4 vjet e gjysmë në Kosovë po realizohet më ngadalë dhe në paqe. Kush e ndihmon dhe e pranon “Zajednicën” e Serbisë në Kosovë, ai e ndihmon dhe e pranon edhe Serbinë edhe Rusinë. Pra, pranimi, njohja, mbrojtja kontributi për “Zajednicën” është kontribut për Rusinë. Lideri i serbëve të Bosnjës, Milorad Dodik, është shumë më i afërt me Putinin e Rusisë sesa me Vuçiqin e Serbisë. “Zajednicën” sot nuk po ua jep serbëve të Kosovës, po ia jep Beogradit dhe po ia jep Moskës.

Ne nuk mund të jetojmë me ankthin e mundësisë së ringjalljes së “Zajednicës”, prandaj jemi të bindur që kjo Qeveri duhet të shkojë e ky president, apo ky kandidat për president, nuk duhet të kalojë.

Të nderuar qytetarë të Republikës,
Deputetë të Kuvendit,

Unë nuk besoj që përgjithësisht, ju që jeni këtu, s’po flas për secilin prej jush, por përgjithësisht, që do të thotë secili prej këtyre që janë në Qeveri, nuk i duan Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por e duan vetveten. Këta i keqpërdorin Shtetet e Bashkuara të Amerikës për partneritetin e tyre, më falni, për pushtetin e tyre kundër opozitës, pra i keqpërdorin SHBA-të për pushtet kundër opozitës, e nuk i mirëpërdorin SHBA-të për shtetin e Kosovës e kundër armiqve tanë. Prandaj, këta nuk mund të ndërtojnë partneritet me SHBA dhe as aleancë. Ata mund të bëjnë vetëm tifozeri dhe atë tifozeri të pasinqertë. Pra, mos e gënjeni veten, mos ta gënjejnë vetën se kemi partneritet e aleancë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Këtu bëhet tifozeri për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nuk kemi as partneritet dhe as aleancë, e unë dua që ne të kemi edhe partneritet, edhe aleancë.

Ka dy teza, të dy autorëve të shquar të filozofisë politike. Teza e parë thotë se çdo popull e ka qeverinë që e meriton. Teza e dytë thotë që çdo qeveri e ka popullsinë që e krijon. Pra, teza e

parë thotë çdo popull e ka qeverinë që e meriton, teza e dytë thotë çdo qeveri e ka popullsinë që e krijon.

Unë besoj në këtë tezën e dytë. Unë besoj se gjendja e popullsisë sonë është pasojë e kësaj qeverie dhe e qeverisjeve të mëhershme.

Ne nuk i kemi partnerë ekonomik SHBA-të. Mos të gënjejnë veten. Shikoni statistikën e shkëmbimeve tregtare, ato na tregojnë se ne kemi partner armikun tonë Serbinë e cila zyrtarisht na i merr 400 milionë në vit duke na shitur neve mallra.

SHBA nuk blejnë mallra të Iranit. Nuk ka marrëveshje për tregti të lirë midis vendeve që s'kanë marrëveshje politike.

Po ashtu, ju e dini që në vitin 2003 bojkotoheshin verërat franceze, atëherë kur Franca e kundërshtoi intervenimin e SHBA-ve në Iran.

Si qenkemi ne aleatë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e 17 vjet pas lufte, ne nuk kemi ushtri?

SHBA-të shquhen për ushtrinë më të fortë në historinë e njerëzimit, jo vetëm sot në botë. E si bëhet që ne jemi aleatë qe 17 vjet e nuk kemi ushtri.

Pra, a dini çka, të nderuar qytetarë të Republikës dhe ju deputetë të Kuvendit! Po të ishte çështja e ushtrisë tender, moti ishte krye. Moti e kishin krye këta ushtrinë me pas qenë tender, se kishte pasur të vjedh aty.

Po ne nuk kemi ushtri se ushtria s'bëhet me tender. Për shkak se ushtria s'bëhet me tender, ne nuk kemi ushtri.

Është absurde që 17 vjet themi se jemi aleatë me superfuqinë më të madhe të historisë së njerëzimit dhe aktuale në botë, e ne nuk kemi ushtrinë tonë.

Prandaj, unë dua që ne t'i domi Shtetet e Bashkuara të Amerikës! Por po them popullsinë e kemi në gjendjen që kjo qeveri e ka krijuar dhe kjo nuk është një gjendje e dashurisë për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo është një gjendje e ankthit të mundësisë së braktisjes.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk mund të lidhen me shtete të dështuara. Superfuqia numër 1, s'mund të ketë partneritet një shtet buzë dështimit. Nuk mund ta kenë partner ose aleat një shtet të kapur.

Ne me "Zajednicën" brenda vendit tonë kurrë s'mund të bëhemi as partnerë as aleatë.

Ju a po e shihni që tashmë Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjithnjë e më shumë po orientohen kah Kroacia dhe kroatët se sa kah Kosova e shqiptarët. Dhe, ka një arsye të fuqishme për këtë. Kush ka ndërtuar shtet funksional pa korrupsion, kush ka bërë ushtri, demokraci,

parlamentarizëm, ekonomi? Jo, ne! Kroacia! Kroacia s'ka lejuar "Zajednicë". Ata bëhen partnerë, jo ne, jo Bosnja. Jo ne që po dëshirojmë të na bosnjëzojnë këtu.

Pra, unë besoj që populli do që t'i dojë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por kjo Qeveri nuk po e lejon një gjë të tillë.

Na kanë sjell në situatën ku, sikur ai fëmija trevjeçar në plazh i cili humbet në plazh dhe nuk e di që ka humbur por beson që nëna do ta braktisë. Është ankthi i mundësisë së braktisjes. Ky është...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Regjia, ia mundësoni ta vazhdojë fjalën!

ALBIN KURTI: ...U dëshmua pra e vërtet ajo që thashë unë, se frika nuk ka vend për dashuri.

Unë Amerikën e shoh si frymëzim për pavarësinë e sovranitetin, për demokracinë e drejtësinë, ndërsa ju Amerikën e shihni me frikë. Ju e shihni Amerikën si përbindësh së cilës duhet t'i tutemi ne dhe gjithë populli. Para këtij përbindëshi imagjinar, ju qeveritarë dhe sejmenët tuaj në ulëset e deputetëve serviloseni, poshtërohni dhe prostituoheni. Por, Amerika nuk është ajo e mendjeve tuaja të sëmura.

Unë jam i bindur që vullneti i popullit të Kosovës, është i pandalshëm, sepse e drejta është në anën e tij, në anën e interesit të tij. Mirëpo është në anën e interesit edhe të secilit të juve, që sot të mos e votoni këtë kandidat duke e shndërruar në president.

Le të mos jemi pengë si 2 milionë qytetarë të ambicieve të ulëta për pseudokarrierë të një njeriu të vetëm. Nuk kemi seancë të jashtëzakonshme për interesa jetike të vendit, por për nevojat karrieriste të një personi.

Ne jemi të vendosur që të protestojmë. Ne jemi të vendosur që do të ju ndalim dhe natyrisht që ne nuk mund të mos kemi sukses, sepse Kosova është atdheu i ynë dhe ne vend tjetër nuk kemi.

Ju e keni shtruar infrastrukturën e arratisjes së popullsisë prej vendit, por ne e kemi shtruar infrastrukturën e protestave, e zërit të popullit që do të ju ndalë juve. Faleminderit!

KRYETARI: Të nderuar deputetë, i kemi edhe dy deputetë të paraqitur për fjalë. Zonja Ganimete Musliu, dhe të përgatitet i fundit për diskutim zoti Pal Lekaj.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kolege dhe ju kolegë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

U fol shumë për Amerikën, dhe unë s'e kam ndërmend të flas për Amerikën se e di që Amerika nuk ka nevojë për fjalimet tona sot në Kuvend mirëpo nuk mund të mos flas për Drenicën kur të flasim, meqë jam deputete dhe vi nga Drenica dhe sot u moralizua dhe u thirr shumë në emër të Drenicës.

U tha këtu se Hashim Thaçi nuk e ka përkrahjen e Drenicës. Unë i them sot Hashim Thaçit se Drenica ka qenë me ty, ka qenë dhe do të jetë çdoherë, sepse je në rrugën e drejtë.

Desha t'i tregoj Rexhës, si kolegë që e kam. Rexhë, the që Drenica nuk është me Hashim Thaçin. Merre raportin e KQZ-së, dhe në Açarëvë nga 1 200 vota që i ka PDK-ja, ti i ke vetëm 14 vota në katundin tënd.

Rexhë, në Prekaz nuk e ke asnjë votë dhe jam e bindur që s'ke me pas asnjëherë, sepse Prekazi e di ku të radhitet.

U tha këtu që Sylejman Selimi dhe Sami Lushtaku janë në burg. Po, e di që janë në burg, e dimë të gjithë se janë në burg dhe e dimë pse janë në burg. Sepse, kolegët tu të rendit të parë dhe të dytë, Rexhë, kanë deponuar qindra e mijëra dosje për Sami Lushtakun, për Sylejman Selimin, për "Grupin e Drenicës" në përgjithësi dhe të gjithë ata të burgosur. Dhe sot, më erdhi shumë keq dhe shumë rënd që në këtë Kuvend u bë një fyerje shumë e rëndë "Grupit të Drenicës" sidomos, dhe të gjithë ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kur kauza e tyre krahasohet me kaosin e rrugaçëve. Sepse, thjeshtë, të krahasohet kauza e Sylejman Selimit, e Sami Lushtakut, "Grupit të Drenicës" në përgjithësi dhe të gjithë ushtarëve të UÇK-së, të krahasohet me akuzën e Glauk Konjufcës, është fyerja më e madhe që mund t'i bëhet këtij grupi.

(Ndërrhyrje)

Po, shumë kam! Por nuk do të marrë kohë sepse duhet t'i grahim pak më shpejt procedurave se do t'i bashkëngjitemi festës, sepse Kosova sot ka festë.

Por, edhe një. Do t'i kërkoj falje Rafet Ramës dhe juve që më duhet ta bëj një tërheqje pak prej fjalës time, sepse dua t'i bashkëngjitem apelit të nënës së Rafet Ramës që unë sot duhet ta votoj Hashim Thaçin, sepse Hashim Thaçi e meriton ta votoj, prandaj ju ftoj edhe juve ta votoni Hashim Thaçin.

KRYETARI: Faleminderit! I nderuar deputet Pal Lekaj, jemi në përfundimin e diskutuesve. Edhe profesori Sabri Hamiti pastaj, sepse e ka kërkuar fjalën, dhe pastaj do të futemi në procedura.

PAL LEKAJ: Të dashur qytetarë të Republikës,
Të dashur protestues që sot jeni në përkrahje të Kosovës,
Deputetë të nderuar,
Me çka duhet të krenohemi ne sot? Me degradim të shëndetësisë, me degradim të arsimit, me papunësi, me jozhvillim ekonomik, me degradim të drejtësisë dhe me gjithçka tjetër përpos asaj që quhet e mirë e Kosovës.

Zoti Thaçi dhe zoti Mustafa,

Jeni dy personalitete, dy personazhe që po e shkatërroni vendin, që e keni shkelur Kushtetutën, që është akti më i rëndë dhe Kosova po rrëshqet me anarki.

Zoti kryeministër dhe zoti Thaçi,

Pse nuk shkoni në Prekaz te Adem Jashari dhe t'i thoni - ne jemi tradhtarët e këtij vendi, sepse luftuam për ta shkelur këtë vend, për ta copëtuar.

Pse nuk shkoni te varri i Shkëlzenit dhe i Luanit e t'i thoni të njëjtat fjalë që ne e shitëm tokën e Kosovës.

Pse nuk shkoni te Ibrahim Rugova dhe t'i thoni - nuk është ëndrra e juaj për një demokraci dhe një zhvillim më të mirë.

Pse nuk shkoni te Zahiri që t'i thoni se kjo Kosovë është e ndarë dhe nuk ka prosperitet.

Athua edhe kur është bërë suprimimi i autonomisë së Kosovës kaq nuk kam parë në këtë Kuvend. Nuk kam parë kaq njerëz që nuk dihet kush janë dhe nuk kam parë që njerëzit, do të thotë, kanë qenë në përkrahje që mos të suprimohet autonomia e Kosovës dhe sot i ke në shesh që të mos bëhet Thaçi president.

Athua ju deputetë të nderuar, a do të jeni ata njerëz që nesër para fëmijëve tuaj do t'i thoni se ne votuam Thaçin dhe e shkatërruam vendin.

Athua ju deputetë do t'i thoni se ne votuam këtë qeveri dhe po vazhdon kjo qeveri e turpit, që e shkeli me 23 nene Kushtetutën e Kosovës.

Prandaj, le të jetë turp i juaj dhe ne asnjëherë nuk do ta pranojmë Thaçin si person unifikues. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamiti e ka fjalën!

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Po shihet se ka një sezon që këtu s'ka debate, prandaj sot edhe pse s'është ditë debati, po zhvillohen debate. Domethënë Kuvendi është tjetërsuar moti nga funksioni që e ka pasur, arsyet i dinë të gjithë dhe nuk dua të komentoj më tutje.

Unë në të vërtetë dola të jap një deklaratë krejt të shkurtër, për të mos thënë me një fjali.

(Opozita hedh gaz lotsjellës në sallën e mbledhjeve plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.)

(Ndërprerje)

KRYESUESI: Të bëjmë një pauzë prej 10 minutave!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Le të reagojë menjëherë ndihma e shpejtë. Një deputet është në gjendje të rëndë. Është ky deputeti i “Vetëvendosjes”. Largojeni prej ambientit, kapeni së të mundeni dhe largojeni në ajër të pastër.

(Ndërprerje)

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë me punimet e seancës.

Ju njoftoj se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, të mbajtur sot, më 26 shkurt 2016, në orën 15:00, ka marrë këtë:

V e n d i m

Për largimin e deputetëve të Kuvendit nga pjesëmarrja në seancë: Ismajl Kurteshi, Faton Topalli, Time Kadrijaj, Pal Lekaj, Teuta Haxhiu dhe Bali Muharremi, për shkak se me sjelljen dhe veprimet e tyre pamundësuan zhvillimin e punimeve të seancës plenare, prandaj kërkohet të largohen nga pjesëmarrja në seancën plenare.

Më 26 shkurt 2016.

(Ndërhyrje)

Me mirësjellje dhe mirëkuptim do të ishte mirë vetë ta lëshoni seancën.

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se me procedurën për zgjedhjen e presidentit të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës:

1. Presidenti i Republikës së Kosovës, zgjidhet me votim të fshehtë.
2. Për zgjedhjen e presidentit të Republikës së Kosovës gjatë 3 votimeve, duhet të ketë më shumë se 1 kandidat.
3. Presidenti i Republikës së Kosovës në votimin e parë dhe në votimin e dytë zgjidhet me 2/3 e votave të gjithë deputetëve të Kuvendit me të paktën 80 vota për.
4. Në votimin e tretë presidenti i Republikës së Kosovës zgjidhet me shumicën e votave të gjithë deputetëve me të paktën 61 vota për.
5. Në votimin e parë duhet të marrin pjesë të paktën 80 deputetë.

Nëse në votim marrin pjesë më pak se 80 deputetë, konsiderohet se nuk ka kuorum për vendimmarrje, andaj duhet të përsëritet votimi i parë.

Nëse në votimin e parë asnjëri kandidat nuk merr votat e mjaftueshme, të paktën 80 vota për, organizohet votimi i dytë.

Ju lutem, mos pengoni për të larguar gazin, për arsye se përjashtohen ata deputetë të cilët pengojnë punimin e seancës. Ju lutem, mos pengoni!

Në votimin e dytë duhet të marrin pjesë të paktën 80 deputetë.

Nëse në votim marrin pjesë më pak se 80 deputetë, konsiderohet se nuk ka kuorum për vendimmarrje, andaj duhet të përsëritet votimi i dytë.

Nëse në votimin e dytë asnjëri kandidat nuk merr votat e nevojshme, pra të paktën 80 vota për, organizohet votimi i tretë.

Në votimin e tretë duhet të marrin pjesë të paktën 61 deputetë. Nëse në votim marrin pjesë më pak se 61 deputetë, konsiderohet se nuk ka kuorum për vendimmarrje, andaj duhet të përsëritet votimi i tretë.

Nëse në votimin e tretë asnjëri kandidat nuk merr votat e nevojshme, të paktën 61 vota për, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e reja të cilat duhet të mbahen brenda 45 ditësh.

Meqë gjedhja e presidentit bëhet me votim të fshehtë, kjo nënkupton krijimin e një komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të Administratës.

Andaj, para se të procedojmë me votim të fshehtë ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që të propozojnë nga një anëtar për komisionin votues.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, kë e propozon për komision? Urdhëroni, Adem Grabovci!

ADEM GRABOVCI: Grupi Parlamentar i PDK-së propozon Selvije Halimin anëtare të komisionit.

KRYETARI: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës?

(Opozita hedh gaz lotsjellës në sallën e mbledhjeve plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.)

Kemi pauzë për 10 minuta, ndërsa ne në sallën 301 me kryetarët e grupeve parlamentare.

(Ndërprerje)

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
E vazhdojmë seancën. Jemi te Komisioni votues. Partia Demokratike e Kosovës e ka propozuar anëtarin e vet Selvije Halimi.

Lus Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës të propozojë anëtarin e komisionit.
Urdhëroni zotëri Beqiri!

Kujdes deputetë, sepse po e vetëpërrjashtoni veten me rezistencë! Ju lutem! Kujdes, ju lutem!

E nderuara Aida! Jemi kolegë, të lutem qetësohuni e të vazhdojmë seancën, të lutem!
Largojeni gazin lotsjellës! Zafir, të lutem, nuk jemi duke bërë debat për qejf. Mos, të lutem, sepse po e din vet pse janë ardhur, sepse shumica janë dashamirës tu.

Ismet Beqiri, e merr fjalën!

ISMET BEQIRI: Ne propozojmë deputeten Njomëza Emini!

KRYETARI: Grupi Parlamentar Vetëvendosje, propozoni anëtarin e komisionit.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, propozoni anëtarin e Komisionit.

Lista serbe? Urdhëroni zotëri Simiq dhe ju kisha lutur vetëm pak për qetësi.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala vam predsedniče!
Poslanička Grupa Srpske liste za člana izborne komisije predlaže našeg poštovanog kolegu Sašu Milosavljević. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! “6+”, zoti Damka!

FIKRIMN DAMKA: Faleminderit i nderuar kryetar!
Grupi 6+ e propozon Duda Baljen!

KRYETARI: Faleminderit “6+”! Urdhëro Ilir, deklarohu!

ILIR DEDA: Në emër të opozitës së bashkuar, unë do të jam anëtar i komisionit.

KRYETARI: Nuk ke të drejtë vetveten ta propozoni. Le të propozojë ndokush tjetër dhe urdhëroni, merreni fjalën. Urdhëro Ilir, vazhdo! Ju lutem, nuk kemi nevojë të bëjmë debat në mes deputetëve! Urdhëroni, Donika, kë po e propozoni!

(Ndërrhyrje)

Atëherë, më vjen keq, mbeteni pa anëtar. Dëgjoni, nuk keni nevojë të reagoni, ju lutem. Donika, nëse nuk e aktivizon kemi instruksione drejtpërdrejt nga Rregullorja se nuk lejohet. Kjo është ajo që s'mund të pranoj. Urdhëro!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Ju jeni njeriu i fundit pas shkeljeve të jashtëzakonshme kushtetuese që keni të drejtë të flisni për Rregulloren e këtij Kuvendi.

Ilir Deda do të jetë anëtar i komisionit në këtë proces, në emër të opozitës.

KRYETARI: Faleminderit shumë zonja Kadaj-Bujupi propozon Ilir Dedën.

Lus deputetët që me ngritjen e dorës le të deklarohen për emërimin e komisionit. Ju lutem, të deklarohen kryetarët e grupeve parlamentare.

(Ndërprerje)

Aida, jeni duke e sulmuar punëtorin e kujdestarisë! Ju kisha lutur, për kujdes!

(Ndërprerje)

Tash po vazhdojmë mbledhjen. Uluni! Urdhëro Labinota!

LABINOTË DEMI: Vota është e gjithsecilit, kolege deputete të opozitës, kemi kolege shtatzëne, kujdes keni!

KRYETARI: Shefat e grupeve parlamentare, kisha kërkuar, nëse e aprovoni ju, e kam një propozim. Nga grupi i pavarur i deputetëve ta futni në komision edhe një.

Unë e kisha propozuar Blerim Shalën, nëse ju e pranoni!

Pra, i kemi propozimet e grupeve parlamentare të pozitës dhe opozitës. A ka mundësi që me ngritje dore të deklaroheni në rend të parë si është gjendja. Kolegët e opozitës u vetëlarguan nga pjesëmarrja në seancë.

Lus Administratën të na e japë gjendjen e kuorumit dhe në të njëjtën kohë kisha kërkuar qetësi.

Selvije Halimi, në Komisionin votues nga Partia Demokratike e Kosovës; Njomza Emini, nga Lidhja Demokratike e Kosovës; Ilir Deda, nga Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”; nga Lista Serbe, Sasha Milosavljeviq, nga “6+”, deputeti Danush Ademaj.

Ky është Komisioni votues. Grupi Parlamentar i AAK-së nuk ka dhe Grupi Parlamentar “Nisma” nuk kanë anëtar në Komisionin votues.

Të nderuar kolegë deputetë,

Për hir të transparencës sa më të madhe, deputetët do t'i thërras emër për emër. Mos dilni! Deputetët që janë të thirrur në emër, e marrin fletëvotimin edhe vazhdojnë.

Ju kisha lutur, nuk e dua asnjë pjesëtar të sigurimit në sallën e Kuvend. Asnjë! Rrini jashtë salle, ju kisha lutur. Kutitë e votimit janë këtu:

Abdyl Imeri, Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Alma Lama, Anton Quni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Azem Sylja, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftija, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Besnik Bislimi, Bislim Zogaj, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrarti, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Enver Hoxhaj, Etem Arifi, Fadil Beka, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gezim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivkoviç, Jelena Bontiq, Kujtim Paçaku, Labinotë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Kadri Veseli,...

(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

...Margarita Kadriu, Melihate Tërmkolli, Mexhide Mjaku, Milazim Haliti, Milena Miliçeviq, Milka Vuletiq, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj, Njomza Emini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Qela, Ramiz Kelmendi, Rexhep Selimi, Rustem Berisha, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Shala-Berisha, Salih Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavleviq, Selviqe Halimi, Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukrije Bytyqi, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Sërgjan Popoviq, Synavere Rysha, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhevahire Izmaçu, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti, Xhavit Haliti.

(Drejtimitin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

Në qoftë se ka mbetur dikush pa votuar nga deputetët, ose nuk ju ka thirrur emri, le të urdhërojë, për hir të korrektësisë. Faleminderit!

* * *

Të nderuar deputetë, ta dëgjojmë rezultatin e votimit. Urdhëro, zonja Halimi e ka fjalën, në emër të Komisionit votues.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit!

Hashim Thaçi,
E pavlefshme,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,

Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme,
Hashim Thaçi,
Rafet Rama,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme,

E pavlefshme,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme,
Rafet Rama,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme,
Rafet Rama,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Rafet Rama,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Rafet Rama,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme,
E pavlefshme dhe
E pavlefshme.

* * *

KRYETARI: Urdhëroni e nderuara Halimi!

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni votues për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës:

R a p o r t

për rezultatet e votimit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës

Në mbështetje të neneve 65, pika 7 dhe 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nenit 27 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni votues, i formuar me vendim të seancës plenare, më 26 shkurt 2016, në përbërje nga një përfaqësues prej secilit grup parlamentar, numëron votat e deputetëve dhe konstaton, si në vijim:

Pas zhvillimit të votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës në seancën plenare, të mbajtur më 26 shkurt 2016, konstaton si në vijim:

Në votim kanë marrë pjesë 81 deputetë:

- Të pavlefshme janë 27 fletëvotime.
- Për zotin Hashim Thaçin kanë votuar 50 deputetë,
- Për zotin Rafet Rama kanë votuar katër deputetë.

Në bazë të rezultateve të votimit në pajtim me nenin 86, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 27 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se duhet të përsëritet votimi me dy kandidatët në rundin e dytë.

Prishtinë, 26 shkurt 2016.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, e nderuar Halimi!

Tani vazhdojmë me rundin e dytë të votimit. Administratës i duhen dhjetë minuta t'i përgatisë fletëvotimet dhe vazhdojmë me votim.

I ftoj deputetët t'i zënë vendet, jemi në vazhdimin e seancës. Atëherë, regjia le t'i ftojë deputetët që të kthehen në sallë. Ilir Deda ndërkohë e ka fjalën. Urdhëro, Ilir!

ILIR DEDA: Vetëm po dua të ju sqaroj, unë jam i nominuar prej tri partive opozitare. Tash tri partitë opozitare kanë kërkuar prej meje, të nominuarit të tyre, që të tërhiqem, dhe unë tërhiqem. Ju vazhdojeni procesin.

(Ndërprerje e incizimit)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: ...Besa Baftija, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Besnik Bislimi, Bislim Zogaj, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Enver Hoxhaj, , Ethem Arifi, Fadil Beka, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gezim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Kujtim Paçaku, Labinotë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj Gutaj, Margarita Kadriu, Melihate Tërmkolli, Mexhide Mjaku Topalli, Milazim Haliti, Milena Miliçević, Milka Vuletiq, Mufera Shinik, Muhamet Mustafa, , Murat Hoxha, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj, Njomza Emini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Qela, Ramiz Kelmendi, Rexhep Selimi, Rrustem Berisha, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Shala-Berisha, Salih Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavleviq, Selvije Halimi, Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukrije Bytyqi, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Sërgjan Popović, Synavere Rysha, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami,

Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme
E pavlefshme,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme,
Rafet Rama,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme,
Rafet Rama,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
E pavlefshme,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,

* * *

KRYESUESI: Fjalën e ka kryetarja e Komisionit, zonja Halimi.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!
Të nderuar kolegë deputetë,

R a p o r t i

për rezultatet e votimit për zgjedhjen e presidentit të Republikës së Kosovës

Në mbështetje të nenit 65, pika 7 dhe 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 27 të Rregullores së Kuvendit, komisioni i formuar me vendim të seancës plenare më 26 shkurt 2016, nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare, pas zhvillimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e presidentit të Republikës së Kosovës, në seancën plenare, e mbajtur më 26 shkurt 2016, në votimin e dytë konstaton, si në vijim:

Në votim kanë marrë pjesë 81 deputetë:

- Të pavlefshme janë 15 fletëvotime,
- Për zotin Hashim Thaçi kanë votuar 64 deputetë,
- Për zotin Rafet Rama kanë votuar 2 deputetë.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 27 të Rregullores së Kuvendit konstatohet se të dy kandidatët duhet të shkojnë në rundin e tretë të votimeve.

Prishtinë,
26 shkurt, 2016

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Lus Administratën dhe teknikën që të bëhen gati për votimin tjetër, derisa të shtypen fletët besoj që pjesëtarët e grupeve mund të pinë ndonjë kafe, ujë apo diçka...

* * *

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Zini vendet! Jemi në vazhdimin e seancës. Administrata tashmë e ka konsumuar kohën, është përgatitur për votim. Tani mund të vazhdojmë.

Lus kryetarët e grupeve parlamentare që t'i thërrasin deputetët që të kthehen në sallë.

Të nderuar kolegë deputetë,
Jemi në rundin e tretë të votimit, në vazhdimin e seancës. Ndërkohë 81 deputetë janë aktualisht brenda në sallë, 82.

Ndërkohë, njëri nga kolegët deputetë e dëshiron fjalën. Urdhëro Fisnik!

Vetëm pak, ju lutem! A ka mundësi qetë? Ju lutem, kujdestaria largohuni, lirojeni... Po, po, vetëm ju kisha kërkuar... Urdhëro, Fisnik!

FISNIK ISMAILI: Opozita e bashkuar e nominon deputetin Ilir Deda për në Komisionin për votim. Faleminderit!

KRYETARI: Kush është për Ilir Dedën në Komisionin votues nga Lëvizja "Vetëvendosje", me votim formal. Urdhëro Hajdar, pasi e dëshiron fjalën.

HAJDAR BEQA: Kryetar,

Zoti Ismaili ka të drejtë ta propozojë zotin Deda në emër të “Vetëvendosjes”, jo në emër të opozitës së bashkuar. Kushtetuta njih grupet parlamentare, e nuk njih opozitë të bashkuar, as opozitë. Dhe, mendoj që duhet të propozohet si anëtar nga Grupi Parlamentar “Vetëvendosja”. Faleminderit!

KRYETARI: Dëgjoni, kijeni parasysh! Një deputet i Lëvizjes “Vetëvendosje”, Fisnik Ismaili, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” e propozoi po ashtu një deputet të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ilir Dedën, anëtar të komisionit. E aprovojmë formalisht vetëm me ngritje formale dore në komision? Ai u deklarua, ai dëshiron të jetë, ja ku është. Me ngritje formale dore, ju lutem! Ilir Deda, deputet i Lëvizjes “Vetëvendosje”, është në Komisionin votues.

Në sallë janë 83 deputetë. Vazhdojmë me procesin e votimit:

Abdyl Imeri, Melihate Termkolli,...

(Ndërprerje e incizimit)

Më lejoni, ndërkohë, derisa votohet, të nderuar deputetë, t’ju drejtohem vetëm sonte, në këtë natë të veçantë, kemi manifestimin për 80-vjetorin të lindjes së nderit të kombit Adem Demaçi, i cili mbahet nën patronatin e Shoqatës së të Burgosurve Politikë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës. Desha edhe në emrin tuaj, bashkërisht, unë isha në manifestim, t’ia uroj 80-vjetorin, ditëlindjen heroit, nderit të kombit, Adem Demaçi. Urime e rroftë sa malet!

...Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Agim Aliu, Agim Çeku, Alma Lama, Anton Çuni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Azem Sylja, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftija, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Besnik Bislimi, Bislim Zogaj, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Enver Hoxhaj, Ethem Arifi, Fadil Beka, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gezim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kujtim Paçaku, Labinotë Demi-Murtezi, Lahi Ibrahimaj, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Margarita Kadriu-Ukelli, Mexhide Mjaku-Topalli, Milazim Haliti, Milena Miliçević, Milka Vuletiq, Mufera Serbica-Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Kadri Veseli, Mytaher Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani,...

(Ndërprerje e incizimit)

(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

...Naser Osmani, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj, Njomza Emini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Qela, Ramiz Kelmendi, Rexhep Selimi, Rrustem Berisha, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Salih Morina, Salih

[illegible]

(*Duartrokitje*)

KRYETARI: Ju lus deputete, vazhdo numërimin e votave!

SELVIJE HALIMI: Jemi ende në numërimin e votave, ju lutem!

Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,

Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi,
Hashim Thaçi.

(Duartrokitje)

Ju lutem! Komisioni le ta kryejë punën e vet formale, zyrtare.

Ju lutem për vëmendje të nderuar deputetë. Fjalën e ka zonja Halimi, për raportimin përfundimtar të komisionit votues.

SELVIJE HALIMI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryetar i Kuvendit dhe nënkryetarë,
Të nderuar kabinet qeveritar,
Të nderuar të pranishëm,
Pas zhvillimit të votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e presidentit të Republikës së Kosovës, në seancën plenare të mbajtur më 26 shkurt 2016, në votimin e tretë, komisioni konstaton, si në vijim:

Në votim kanë marrë pjesë 81 deputetë:

- Të pavlefshme janë 10 fletëvotime.
- Për zotin Hashim Thaçi kanë votuar 71 deputetë.

(Duartrokitje)

Për Rafet Ramën nuk e kemi asnjë votë!

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 86 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 27 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se zoti Hashim Thaçi zgjidhet president i Republikës së Kosovës me mandat pesëvjeçar.

Prishtinë, 26 shkurt 2016.

Urime!

KRYETARI: Faleminderit! E falënderojmë në mënyrë të veçantë tërë Komisionin votues, i cili e ka bërë një punë të jashtëzakonshme, një punë shumë transparente.

E falënderoj edhe përfaqësuesin e opozitës, në të njëjtën kohë.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Pas këtij raportimi të komisionit, konstatoj se nga ky Kuvend dhe nga sot Kosova e ka presidentin e vet të ri, të zgjedhur në mënyrë demokratike.

Urime dhe të ndihmoftë zoti Hashim Thaçi, president i Republikës së Kosovës,
Urime të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës!

E ftoj presidentin e ardhshëm të Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi, që ta paraqesë një fjalë rasti.

PRESIDENTI I POSAZGJEDHUR, HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Kadri Veseli!

I nderuar kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa,
Kabinet qeveritar,

Deputetë të respektuar,

Qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,

Të nderuar ambasadorë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Bashkimit Evropian dhe të gjithë ju diplomatë sot që jeni të pranishëm,

Fillimisht dëshiroj që t'ju falënderoj juve deputetë të nderuar për besimin ndaj meje.

Ky është një besim për një detyrë e përgjegjësi edhe më tepër për t'i shërbyer vendit, për t'u shërbyer të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Ju falënderoj shumë të nderuar ambasadorë për qëndrimin tuaj të vazhdueshëm gjatë tërë ditës me ne në një proces të zgjedhjes së presidentit të Republikës së Kosovës.

Dëshiroj që t'i falënderoj të gjithë deputetët e të gjitha partive politike që janë të pranishëm sot në votim dhe natyrisht i përshëndes të gjithë njerëzit e skenës politike kosovare.

E falënderoj Partinë Demokratike të Kosovës, Lidhjen Demokratike të Kosovës. E falënderoj Listën serbe, falënderoj "6+", i falënderoj deputetët e pavarur dhe e respektoj me përlësinë më të madhe besimin tuaj.

Ju siguroj se besimi juaj do të jetë një shpresë e re, një optimizëm i ri për Republikën e Kosovës.

Ju siguroj se do të punoj gjithmonë në shërbim të vendit, do të punoj gjithmonë në shërbim të gjithë qytetarëve, duke e respektuar gjithmonë Kushtetutën, duke e respektuar funksionimin e pavarur të institucioneve demokratike të vendit, duke punuar për rend dhe ligj, duke u shërbyer të gjithë qytetarëve, pa dallime etnike.

Do të jemi në shërbim të të gjithëve për ta ndërtuar Kosovën e re, për ta ndërtuar Kosovën evropiane, për të punuar edhe më fuqishëm për anëtarësimin e Kosovës në NATO, në Bashkimin Evropian dhe për t'i forcuar edhe më tepër marrëdhëniet tona të shkëlqyeshme e të përjetshme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Dëshiroj edhe një herë t'i falënderoj të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që për një dekadë të tërë ma kanë besuar fuqinë më të madhe në vend.

Dëshiroj të ju falënderoj ju deputetë të nderuar të opinioneve të ndryshme politike për besimin tuaj.

Të jeni të sigurt se do të punoj edhe më fuqishëm në institucionalizimin e dialogut politik, si kusht i domosdoshëm për të ardhmen tonë stabile, në paqe, progres, zhvillim ekonomik dhe implementimin e të gjitha prioriteteve tona shtetërore.

Sot, në këtë moment madhështor dhe të veçantë, edhe për mua jetësisht, dëshiroj ta përkujtoj heroizmin e komandantit legjendar Adem Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të lirisë, të kujtoj me respektin dhe pietetin më të lartë për presidentin historik Ibrahim Rugova dhe të gjithë njerëzit që e dhanë jetën për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: E falënderoj presidentin e ardhshëm për fjalën e rastit. Presidenti i Republikës së Kosovës e fillon mandatin pasi ta ketë dhënë betimin para Kuvendit të Kosovës.

Betimi i presidentit të Republikës së Kosovës para Kuvendit do të bëhet në këtë sallë, më 7 prill 2016.

Duke i falënderuar veçanërisht të gjithë ambasadorët e huaj të cilët i kemi të akredituar në Republikën e Kosovës dhe mysafirët, të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e përfundojmë seancën e sotme.

Mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*